


RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK
Për Programin e studimit MSc në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”
Ofruar nga Kolegji Universitar “Bedër”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Dr. Marjana Çadri

Dr Silvana Loka



(Maj/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit MSc në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar “Bedër”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Filologjisë dhe Edukimit
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Licensuar me nr 330, datë 07.08.2012
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Akredituar me UMASH nr 223, datë 04.06.2013
5	Titulli i programit të studimit:	MSc në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7 (shtatë)
16	Numri i studentëve	30 studentë

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Msc në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji

Kolegji Universitar Jopublik "Bedër" funksionon në bazë të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe VKM nr. 286, datë 6.04.2011 "Për licencimin e Shkollës së Lartë Private "Bedër", Tiranë", i ndryshuar, në ligjin nr. 10 056, datë 22.01.2009 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella", si edhe bazuar në aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim të ligjit.

Kolegji Universitar Jopublik "Bedër" është i akredituar me Urdhrin e Ministrit, Nr. 223, datë 04.06.2013 "Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në Bachelor, Master i Shkencave dhe Master Profesional".

Programi i studimit 'Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji', i cili ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Edukimit, është licensuar me Urdhër Nr. 330 datë 07.08.2012.

Programi i studimit "Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji" është akredituar me Urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Nr 2635/22 prot, datë 04.06.2013, i cili përcakton në pikën pikën 9 të tij "Akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë që përfundon me "Master i Shkencave" në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji" të Shkollës së Lartë Private "Hëna e ploë" (BEDËR), në përputhje me vendimin nr. 469, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit.". Me Urdhër të MASH Nr 61, dt 09.02.2016 "për rregjistrimin e formave të diplomave "Bachelor", "Master profesional" dhe "Master i Shkencave" të Shkollës së Lartë private "Hëna e Plotë", (Bedër), Tiranë, është rregjistruar në rregjistrin shtetëror të diplomave ky program me emërtimin Master i Shkencave në "Psikologji këshillimi dhe pedagogji". Me Urdhër të MASH Nr 420, dt 20.09.2017 "Për disa ndryshime në Urdhërin Nr 61, dt 09.02.2016 "Për rregjistrimin e formave të diplomave "Bachelor", "Master profesional" dhe "Master i Shkencave" të Shkollës së Lartë Private "Hëna e Plotë", (Bedër), Tiranë", është ndryshuar emëri i Institucionit nga Shkolla e Lartë Private "Hëna e ploë" (BEDËR) në Kolegji Universitar "Bedër" dhe emërtimi i diplomës është Mastër i Shkencave në "Psikologji Këshillim dhe Pedagogji". Referuar Evidencën Nr 23 në Dosjen e Vetvlerësimit (DVV) emërtimi i diplomës sipas modelit të Diplomës dhe Suplementit të saj është: Master i Shkencave në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji"

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Dr. Marjana Çadri
2. Dr. Silvana Loka

Menaxhere teknike e ndjekjes së kësaj procedure është Specialistja e ASCAL, Znj Suela Kromidha.

Më datë 02.05.2019 është dërguar nëpërmjet sistemit por edhe zyrtarisht Draft RVJ në Institucion. Më datë 06.05.2019 vjen përgjigja/komente nga Institucioni nëpërmjet sistemit mbi këtë Draft. GVJ i pa me vëmendje këto komente dhe nuk merr në konsideratë asnjë prej tyre duke mos bërë ndryshim në Raportin përfundimtar.

Përgjigja e GVJ në lidhje me komentet e KUB për Draft RVJ është në fund të Raportit.

Shënim! Ky grup pune ka bërë vlerësimin e jashtëm edhe të programit Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji në Kolegjin Universitar "Bedër". Duke qenë se disa të dhëna janë të nivelit institucional, grupi i vlerësimit, për të siguruar trajtim të njëjtë dhe të barabartë të këtyre të dhënave në kuadër të vlerësimit të dy programeve të studimit (Bachelor në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji" dhe Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji), ju parashtrojmë se në rubrikat 4, 5 dhe 6 të RVJ do të gjeni referenca të njëjta.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Të krijohet një organizim më institucional në realizimin e aktivitetit mësimor;
- b) Të rritet numri i pedagogëve efektivë dhe me kontratë për të mbuluar fusha specifike të programit të studimit;
- c) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtarisht.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin “Të krijohet një organizim më institucional në realizimin e aktivitetit mësimor”, institucioni zotëron aktualisht një strukturim të aktivitetit mësimor, si në nivel të strukturave, të cilat janë përgjegjëse për zhvillimin dhe përmirësimin e procesit mësimor, edhe në nivel të dokumentacionit përkatës gjithashtu, duke përfshirë: programin mësimor, sylabuset e lëndëve, etj.

Rekomandimi është plotësuar.

- b) Për rekomandimin “Të rritet numri i pedagogëve efektivë dhe me kontratë për të mbuluar fusha specifike të programit të studimit”, institucioni deklaron se ka rritur numrin e stafit efektiv dhe me kontratë për realizimin e planit mësimor. Mbetet për t’u theksuar se stafi akademik, me gradat përkatëse sipas përcaktimeve ligjore (të paktën Dr) në fushën e Psikologjisë është më i pakët, krahasuar me personelin akademik në profilin e Pedagogjisë.

Rekomandimi është plotësuar pjesërisht.

- c) Për rekomandimin “Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtarisht”, institucioni deklaron (në RVB) se sipas akteve ligjore në fuqi studentët duhet të paraqesin dëshminë e gjuhës së huaj mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare përpara diplomimit të tyre. Sikurse përcaktohet në pikën 4, të Nenit Nr. 76 “Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve”, të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë”, “Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht...”. Institucioni ka plotësuar rekomandimin e dhënë në vendimin për akreditimin e parë, por jo detyrimin e dalë nga kuadri ligjor i sipërcituar.

Rekomandimi është plotësuar.



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi Master i Shkencave në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”, ofron përgatitje akademike të përparuar në fushën e këshillimit psikologjik individual dhe në grup si dhe në fushën e pedagogjisë, etj.

Synimet kryesore të programit janë:

- të përgatisë të diplomuar të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale, cilësi të larta morale dhe shoqërore për t'u kthyer në modele frymëzues dhe motivues për shoqërinë;
- të përgatisë njerëz të aftë për të punuar në fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë;
- të përgatisë profesionistë të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e vendit dhe më gjerë në profesionin e psikologut për të ndihmuar shoqërinë në tërësi;
- të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik, të komunikuarit saktë dhe me kuptim të qartë të dimensioneve etike në profesion;
- të përgatisë ekspertë të kërkuar nga tregu i punës;
- të mundësojë një kualifikim shkencor të profesionistëve të rinj me njohuritë e thelluara të psikologjisë dhe pedagogjisë në tërësi;
- të krijojë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

Këto synime sendërtohen në objektivat e përgjithshme të këtij programi studimi, të tilla si:

- t'u japë të diplomuarve arsimimin e duhur dhe trajnimin e thelluar në fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë;
- t'u krijojë atyre një vizion të ri për këshillimin psikologjik në Shqipëri, në përputhje me përvojën e krijuar të plotësuar me konceptet evropiane;
- të përpiqet për të realizuar një status të ri të psikologut në kushtet dhe zhvillimet e reja ekonomiko-politiko-shoqërore që janë krijuar në ditët e sotme;
- programi do të shtrojë alternativa konkrete për zhvillimin e këshillimit psikologjik në bazë të strategjisë kombëtare si dhe të japë ndihmesën e vet për krijimin e nje elite të re të fushës së psikologjisë dhe pedagogjisë.

Në planin startegjik afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjat të Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit është përgatitja e individëve të kualifikuar të Gjuhës dhe të Letërsisë Angleze, Gjuhës dhe Letërsisë Turke, Shkencave të Edukimit, Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji, Programit Arsim Parashkollor dhe Fillor dhe fushave të ngjashme me to, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale; si dhe mbështetjen e kërkimit shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë.

Departamenti i Shkencave të Edukimit në KU “Beder” vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore në përputhje me Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë si pjesë përbërëse e Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit. Në këtë kuadër departamenti bashkëpunon punën mësimore me veprimtarinë kërkimore duke respektuar liritë dhe të drejtat e personelit akademik si dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare të departamentit.

Përgjegjësia profesionale e stafit akademik është edukimi i studentëve dhe përgatitja e tyre si profesionistë të së ardhmes në mënyrë që ata të mund të kryejnë detyrën e rëndësishme të psikologut. Por referuar RVB si dhe informacionet e marra në takimet e organizuara me drejtues të Departamentit të Shkencave të Edukimit si dhe me stafin akademik konstatoam se, programi i studimit nuk është riorganizuar në përputhje me Ligjin e ri “Për Urdhrin e Psikologut në Republikës së Shqipërisë” të hyrë në fuqi më, 26.05.2016. Kjo do të pamundësonte ushtrimin e profesionit të psikologut për studentët e diplomuar në këtë program studimi.

Gjithashtu, ky program studimi nuk siguron as licensimin si mësues, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Ligji Nr. 48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, i cili në nenin 57 ‘Profesioni i Mësuesit’, në pikat 1, 2 dhe 3 të tij përcakton kriteret e formimit akademik për t'u licensuar si mësues në arsimin parauniversitar. Sipas këtyre përcaktimeve, të gjitha nivelet e arsimit universitar dhe pasuniversitar duhet të ishin në fushën e pedagogjisë.

Nisur nga sa më sipër, Programi i studimit “Master i Shkencave në Psikologjinë e Këshillimit dhe Pedagogji” pamundëson edhe ushtrimin e profesionit të mësuesit gjithashtu.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Kolegji Universitar Jopublik “Bedër” ka për mision përgatitjen e individëve të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si dhe mbështetja e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë. Programi i studimit “Master i Shkencave në Psikologjinë e Këshillimit dhe Pedagogji” është hartuar plotësisht në përputhje me frymën e misionit dhe qëllimit të KUB.</p> <p>Nuk ka një studim tregu i cili të mund të referojë nevojën reale për profesionistë në këtë fushë, por RVB dhe vizitat në institucion përcollën nevojën për studentë të diplomuar në këtë program studimi. Gjithsesi, në vijim të objektivave të programit të studimit, studentët nuk do të mund të licensohen as si mësues, as si psikologë, duke e bërë këtë program studimi të papërshtatur në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërkesat e tregut.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me zhvillimin e vendit, duke konsideruar që profesioni i psikologut është gjithnjë e më shumë i kërkuar dhe, si i tillë, po parashikohet gjithnjë e më shumë në organogramën e institucioneve, publike dhe/ose private.</p> <p>Ashtu sikurse është përcaktuar edhe në Statutin e KUB, traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, janë baza e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të mira, ndërkombëtare në përgjithësi dhe ato europiane në veçanti. Dhe ky program studimi është hartuar në përputhje të plotë me këtë vision të KUB.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Ashtu sikurse raportohet në RVB dhe sikurse përcaktohet në “Planin strategjik 2012-2017 dhe 2018-2023”, qëllimet strategjike të KUB përfshijnë forcimin e kriterëve tona të pranimit të studentëve, rritjen e cilësisë së arsimit, rritjen e ndikimit të hulumtimit dhe mbështetjes së risive të këtij institucioni.</p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” është plotësisht në përshtatje me strategjinë për zhvillim të institucionit, sikurse paraqitet në evidencën nr. 5 të dokumentacionit që shoqëron RVB.</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” është hartuar në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, por duhet të riorganizohet sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Në zbatim të Ligjit Nr.10 247, datë 04.03.2010 ‘Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve’, Neni 6 “Fusha e zbatimit të KSHK-së”, në pikën b, përcakton se “Fusha e zbatimit të KSHK-së përfshin kualifikimet në të gjitha</p>

	<p>nivelet e të nxënit, nga ato që kërkohen për hyrjen në punë dhe pjesëmarrje në shoqëri, deri tek ato kualifikime të nevojshme, në nivelet më të larta akademike, si dhe në arsimin e formimin profesional”.</p> <p>Duke iu referuar përcaktimeve të Ligjit “Për Urdhërin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, nr. 40/2016, neni 7 “Kriteret e anëtarësisë”, pika b, sipas të cilit “Anëtarët e Urdhërit duhet të kenë diplomën e studimeve të larta “Bachelor” dhe “Master i Shkencave” ose “Master profesional” në psikologji ose ekuivalent me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse”, <u>GVJ vlerëson se programi i studimit “Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” nuk e plotëson kriterin e sipërcituar, duke sjellë kështu edhe mosplotësimin e kriterëve të nevojshme që kërkohen për hyrjen në punë, duke mos plotësuar as përcaktimet e sipërcituara të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</u></p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>KUB ka hartuar një plan strategjik i cili është një udhërrëfyes për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit si dhe të vetë institucionit më gjerë.</p> <p>Plani strategjik është i orientuar drejt përmirësimit të institucionit duke e konsideruar mësimdhënien dhe procesin e të nxënit si detyllat më të rëndësishme të një institucioni arsimor ashtu sikurse është KUB.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>KUB është një institucion i arsimit të lartë i orientuar drejt formimit të profesionistëve dhe qytetarëve të zëshëm. KUB ka një vëmendje të veçantë ndaj mësimdhënies dhe procesit të të nxënit dhe ka hartuar dokumenta të cilët në mënyrë të vazhdueshme e orientojnë punën e këtij institucioni drejt zhvillimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm.</p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”, është hartuar në përputhje të plotë me dokumentat themeltarë të KUB. Misioni dhe objektivat e këtij programi studimi janë në koherencë të plotë me vizionin, misionin dhe objektivat e institucionit dhe zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi.</p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”, si për nga përmbajtja edhe për nga emërtimi, nuk përmbush plotësisht kriteret që dalin nga Korniza Shqiptare e Kualifikimeve, Ligji Nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara”, Ligji Nr. 40/2016 “Për Urdhërin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji Nr. 48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”. Gjithë kuadri ligjor i sipërcituar përcakton kriteret për licensimin e “Psikologut” dhe “Mësuesit”, profesione të rregulluara me ligj dhe pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit, RVB dhe vizitave në institucion, <u>programi i studimit “Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” nuk e lejon studentin e diplomuar të licensohet në asnjërin nga të dy profesionit që burojnë nga vetë emërtimi i programit.</u></p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

KUB organizohet në dy Fakultete: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit. KUB ka në strukturën e tij gjashtë departamente (nga tre departamente për çdo fakultet), dy qendra kërkimore zhvillimore, si edhe njësitë administrative sipas organogramës së përcaktuar. Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit në KU “Bedër” është i strukturuar sipas Ligjit nr.80/2015. Ai përbëhet nga 3 njësi bazë, të cilat janë baza e



zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore të fakultetit. Departamenti ka për detyrë të nxisë, organizojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij.

Ashtu sikurse përcaktohet edhe në Statutin e KUB, në Nenin 7 "Organigrama", përbërja strukturore dhe organizative e Kolegjit Universitar "Bedër" përfshin: a. pjesën akademike, e cila përbëhet nga organet dhe autoritetet drejtuese akademike, njësitë kryesore (fakultetet), njësitë bazë (departamentet) dhe qendrat kërkimore shkencore dhe b. pjesën administrative, e cila përbëhet nga organet dhe autoritetet drejtuese administrative dhe njësitë e shërbimit.

Kolegjit Universitar "Bedër" për efekt të funksionimit të tij më të mirë mund të parashikojë në rregulloret e tij të brendshme dhe struktura të tjera në rolin e njërive ndihmëse.

Në Nenin 8 të Statutit përcaktohen organet drejtuese, autoritetet drejtuese, si dhe organe të tjera.

Në Kolegjin Universitar "Bedër" organet drejtuese janë:

- a) Senati Akademik;
- b) Bordi i Administrimit;
- c) Rektori;
- d) Dekanati;
- e) Asambleja e personelit akademik;
- f) Asambletë e personelit akademik të njërive kryesore;
- g) Këshilli i Etikës;
- h) Komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin;
- i) Komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit;
- j) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;

2. Në Kolegjin Universitar "Bedër" autoritetet drejtuese janë:

- a) Rektori;
- b) Dekanët;
- c) Përgjegjësit e departamenteve;
- d) Drejtorët e qendrave të kërkimit;
- e) Zv. Rektori dhe Zv. Dekanët;
- f) Administratori i Kolegjit;
- g) Administratorët e njërive kryesore.

Ashtu sikurse përcaktohet në Statut dhe raportohet edhe në RVB, Senati Akademik është organ kolegjal vendimmarrës i Kolegjit Universitar "Bedër", që përcakton politikën e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati Akademik kryesohet nga Rektori dhe mbledhet periodikisht, sipas përcaktimeve në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Senatit.


Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Ashtu sikurse përcaktohet edhe në dokumentat themeltarë të KUB dhe sikurse raportohet edhe në RVB, Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit është i përbërë nga tre departamente:

1. **Departamenti i Shkencave të Edukimit** aktualisht ka në përbërje të tij 8 pedagogë efektiv (PAE), nga të cilët: 1 mban titullin Prof.As. 3 pedagogë mbajnë gradën shkencore "Doktor" dhe 4 pedagogë janë me diplomë Msc (nga të cilët një është Dr në proces) si edhe 3 pedagog me kontratë (PAK), nga të cilët: 2 pedagog me gradën Dr.dhe 1 me Msc.
2. **Departamenti i Shkencave Kompjuterike** aktualisht ka në përbërje të tij 7 pedagogë efektiv (PAE), nga të cilët: 3 pedagogë mbajnë gradën shkencore "Doktor" dhe 4 pedagogë janë me diplomë Msc si edhe 1 pedagog me kontratë (PAK), me gradën Dr.
3. **Departamenti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë Angleze** aktualisht ka në përbërje të tij 8 pedagogë efektiv (PAE), nga të cilët: 5 pedagogë mbajnë gradën shkencore "Doktor" dhe 3 pedagogë janë me diplomë Msc (nga të cilët 1 është Dr në proces) si edhe 1 pedagog me kontratë (PAK), me gradën Dr.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT TË FILOLOGJISË DHE EDUKIMIT



Departamenti i Shkencave të Edukimit është njësi bazë mësimore-kërkimore dhe përfshin dy programe studimi të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” dhe “Arsim Parashkollor dhe Fillor”, si dhe një program të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”.

Mbështetur në RVB konstatojmë se: Dekanatet e Kolegjit Universitar “Bedër” janë organe kolegjinale ekzekutive të njëjve kryesore përkatëse. Dekanati përbëhet nga: a. Dekani; b. Zëvendësdekani; c. Përgjegjësit e njësisë bazë; d. Administratori i njësisë kryesore; Dekanati thirret në mbledhjen e parë nga dekani.

Funksionet e Dekanatis janë: a) harton planin disaveçar të zhvillimit të njësisë kryesore; b) harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Rektorat dhe Senat; c) propozon kriteret për shpërndarjen e burimeve materiale dhe njerëzore akademike të njësisë kryesore; d) harton dhe propozon projektbuxhetin për njësinë kryesore; e) paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre; f) zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik. g) Funksionet e tjera të Dekanatis përcaktohen në rregulloren e tij si dhe në rregulloret e tjera të institucionit.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës, Departamentit të Shkencave të Edukimit

Duke filluar që nga viti akademik 2013-2014, numri i personelit të brendshëm (PAE) dhe personelit të jashtëm (PAK) në Departamentin përgjegjës, si dhe raportet e kualifikimit midis tyre paraqiten si më poshtë vijon:

Në vitin akademik 2013-2014 – 9 PAE/11 PAK

Prof Dr PAE/PAK është 1/0

Prof.as. PAE/PAK është 0/1

Dr/PhD, PAE/PAK është 4/3

Asistentë me PAE/PAK është Msc 4/7

Në vitin akademik 2014-2015 - 7 PAE/9 PAK

Prof. As. PAE/PAK është 2/1

Dr./PhD. PAE/PAK është 1/1

Pedagogë në proces Dr. 3/4

Asistentë me Msc 1/3

Në vitin akademik 2015-2016 – 8 PAE/11 PAK

Prof. As. PAE/PAK është 3/1

Dr./PhD. PAE/PAK është 3/2

Pedagogë në proces Dr. 2/3

Asistentë me Msc 0/5

Në vitin akademik 2016-2017 – 7 PAE/3 PAK

Prof. As. PAE/PAK është 2/0

Dr./PhD. PAE/PAK Është 3/0

Asistentë me Msc 2/3

Në vitin akademik 2017-2018 – 8 PAE/5 PAK

Prof. As. PAE/PAK është 1/0

Dr./PhD. PAE/PAK Është 3/2

Pedagogë në proces Dr. 0/1

Asistentë me Msc 4/2

Në vitin akademik 2018-2019 – 8 PAE/3 PAK

Prof. As. PAE/PAK është 1/0

Dr./PhD. PAE/PAK është 3/2

Pedagogë në proces Dr. 1/0

Asistentë me Msc 3/1

Të dhëna më të detajuara për Stafin në departamente sipas viteve akademike e gjeini në Aneksë Tabela 1

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Struktura organizative e KUB është në përputhje me misionin e këtij institucioni.</p> <p>Sipas RVB, dhe verifikimeve të bëra në dokumentacionin përkatës, rezultojnë se KUB ka dy fakultete: Fakultetin e Shkencave Humane dhe Fakultetin e Filologjisë dhe Edukimit.</p> <p>Secili fakultet në KUB ka tre departamente.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Humane, në të cilin bën pjesë Departamenti i Shkencave të Edukimit, ka një strukturë të plotë organizative, akademike dhe administrative. Departamenti ka një mision të përcaktuar qartë.</p> <p>Në vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Shkencave të Edukimit ka 8 anëtarë efektivë, nga të cilët 1 me gradën Prof. Asoc. Dr., 3 me gradën Dr., 4 me gradën MSc.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Njësitë bazë dhe ato kryesore i kanë përgjegjësitë të përcaktuara në dokumentat themelare të KUB dhe janë të ndërgjegjshëm për to.</p> <p>Njësitë bazë, pasi vlerësojnë nevojat për plotësimin e vendeve vakante si dhe nevojat për zhvillim të Departamentit, përfshihen në rekrutimin e personelit akademik.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

KUB ka një strukturë organizative, akademike dhe administrative në përputhje me detyrimet ligjore. KUB ka dy fakultete, me nga tre njësi kryesore secili.

Çdo fakultet dhe njësi bazë i kanë përgjegjësitë të përcaktuara në dokumentat themeltarë të KUB. Stafet akademike janë të njohur me përgjegjësitë që burojnë nga rolet e tyre.

Njësitë bazë marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rekrutimin e personelit akademik.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit**Pjesa përshkrimore**

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Departamenti i Shkencave të Edukimit në Kolegjin Universitar Bedër, ashtu sikurse paraqitet në RVB dhe sikurse u confirmua edhe nga vizitat në institucion, ka një orientim të qartë lidhur me rekrutimin e personelit akademik me grada shkencore. Personeli akademik që ka mbuluar programin e studimit “Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” ka pësuar ndryshime gjatë viteve në të cilat është ofruar si program pas akreditimit të parë. Ndryshimet kanë ndodhur si në nivel të raporteve midis personelit akademik efektiv dhe atij me kontratë, në nivel të raportit midis gradave shkencore të vetë personelit akademik si dhe në nivel të raportit midis personelit akademik shqiptar dhe atij të huaj.

Njwsia përgjegjëse për programin Msc në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” ka një strukturë complete të stafit akademik mësimdhënës, me pedagogw efektive dhe pedagogë me kohë të pjesshme, të rekrutuar mbi bazën e konkurimit dhe vjetërsisë në punë dhe të kontributeve mësimore dhe shkencore.

KUB ka një procedurë të mirëpërcaktuar të rekrutimit të stafit, e cila përfshin përcaktimin e nevojave për staf akademik nga njësia bazë, përcjelljen e kërkesës për staf të ri te Dekani i Fakultetit dhe zbatimin e procedurës së përzgjedhjes së stafit duke u lehtësuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Pas vlerësimit të dosjes së aplikimit, komisioni i përbërë nga: Dekani i Fakultetit përkatës, Përgjegjësi i Njësisë bazë si dhe nga një personel akademik i njësisë, i përcjell Rektorit të KUB tre kandidaturat më të shumëllojshme. Rektori miraton njërin prej tyre. Pas miratimit, kandidatura shpallet në faqen zyrtare dhe Zyra e Burimeve Njerëzore bën prezantimin me stafin akademik të KUB si dhe përgatitjen e dokumentacionit zyrtar për stafin e ri të rekrutuar.

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga IAL (RVB) si dhe informacioneve të marra në takimin e organizuar me stafin akademik mësimdhënës në këtë program studimi rezultojnë 11 anëtarë. Prej të cilëve 9 me (PAE) nga të cilët 1 anëtar me titullin Prof.As. dhe 3 me gradën Dr. si dhe 5 anëtarë me Msc. Si personel akademik (PAK) janë 2 anëtarë nga të cilët 1 anëtar është me gradën Dr.

Institucioni në realizimin e këtij programi studimi ka rritur numurin e personelit akademik me PAE në raport me PAK, por rezulton se numuri i punonjësve akademik me kualifikim në fushën e psikologjisë është i pamjaftueshëm. Në takimin e organizuar me stafin akademik të programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” konstatoam se personeli akademik i kualifikuar është me grada shkencore nw pedagogji, të përfunduara ose në proces dhe kanë gradën shkencore: Dr.S. G. Dr në pedagogji, E. J Dr në Psikologji-Pedagogji dhe J. T. Dr. në pedagogji. Numri tjetër është me kualifikim MSC.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Duke filluar që nga viti akademik 2013-2014, numri i personelit të brendshëm (PAE) dhe personelit të jashtëm (PAK) i angazhuar në këtë program studimi si dhe raportet e kualifikimit midis tyre paraqiten si më poshtë vijon:

Në vitin akademik 2013-2014 - 8 PAE/3 PAK – Ngarkesa mbulohej në masën 72 % nga PAE

Prof.as. PAE/PAK është 3/1

Dr./PhD, PAE/PAK është 3/2

Asistentë PAE/PAK është Msc 2/0

Në vitin akademik 2014-2015 – 8 PAE/3 PAK - Ngarkesa mbulohej në masën 72 % nga PAE

Prof. As. PAE/PAK është 3/1

Dr./PhD. PAE/PAK është 3/2

Pedagogë në proces Dr. 1/0

Asistentë me Msc 1/0

Në vitin akademik 2015-2016 - 8 PAE/3 PAK - Ngarkesa mbulohej në masën 72 % nga PAE

Prof. As. PAE/PAK është 3/1

Dr./PhD. PAE/PAK është 4/2

Pedagogë në proces Dr. 1/0

Në vitin akademik 2016-2017 - 9 PAE - Ngarkesa mbulohej në masën 100 % nga PAE

Prof. As. PAE/PAK është 2/0

Dr./PhD. PAE/PAK është 4/0

Pedagogë në proces Dr. 2/0

Asistentë me Msc 1/0

Në vitin akademik 2017-2018 – 9 PAE/1 PAK – Ngarkesa mbulohej në masën 90% nga PAE

Prof. As. PAE/PAK është 2/0

Dr./PhD. PAE/PAK është 6/1

Pedagogë në proces Dr. 1/0

Në vitin akademik 2018-2019 - 8 PAE/3 PAK - Ngarkesa mbulohet në masën 72 % nga PAE

Prof. As. PAE/PAK është 1/0

Dr./PhD. PAE/PAK është 3/2

Pedagogë në proces Dr. 1/0

Asistentë me Msc 3/1

Nisur nga të dhënat e paraqitura nga Institucioni të kërkuara gjatë vizitës në vend, GVJ konstaton se ngarkesa e stafit të brendshëm në këtë program është më e larta 112 orë dhe më e ulëta 56 orë. Ndërsa ngarkesa e stafit jo vetëm në këtë program por edhe në programet e tjera të ofruara nga KUB luhatet nga 350 orë (Dr L. C) në 112 orë , *Shiko Anekse, Tabela 3*

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit është paraqitur në fund të raportit, në Anekse, Tabela 4

Këshilli Shkencor i programit të studimit është i përbërë nga tre personel akademik. Këshilli drejtohet nga Drejtuesi i Departamentit dhe koordinatorë është Dr. J. T.

Të dhënat sipas seksit

Mbështetur kryesisht në takimet e organizuara me stafin akademik konstatoam se në Programin e studimeve Msc në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji" dominon staf akademik i seksit femër në raportin 8/3. Theksojmë se stafi i paraqitur në RVB në këtë rubrikë i korespondon stafin në Departament dhe jo stafit në program. Të dhënat për stafin në program janë nxjerrë duke parë dhe duke numëruar një për një stafin në program të shoqëruar me planin mësimor sipas viteve akademike.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Nga të dhënat sipas moshës së personelit që pasqyrohen në dokumentat bazë të personelit në kontratat e punës si dhe RVB konstatoam se dominon moshë 36-45 vjeç (6 PAE dhe 2 PAK) 25-35 (1 PAE dhe 3PAK) dhe 46-55 vjeç (1 PAE). Vërehet një kombinim i moshave, specialiteteve dhe eksperiencave

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Në KU "Bedër" konstatoam se kontratat e punës që nënshkruhen me stafin akademik, janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kontrata e punës janë me afat/ose pa-afat të përcaktuar në bazë të kategorisë së stafit akademik dhe kohës së punësimit. Në to përshkruhen në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrimet që kanë palët nënshkruese të kontratës. Këto të drejta dhe detyrime i bëhen të ditura stafit në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe aneksit të saj. Kontrata e punës bazohet në ligjin nr. 80/2015 datë, 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Gjatë takimit me stafin akademik u vu re informimi i tyre për detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë për vendin e punës dhe në zyrën e burimeve njerezore u njohëm me dokumentacionin për disa anëtarë të personelit akademik efektiv dhe me kontratë.

Dokumentacioni i zyrës së burimeve njerezore ishte i plotë, i organizuar mirë dhe në mënyrë profesionale, elektronikisht dhe në hardcopy në përputhje me kërkesat e institucionit dhe kodit të punës.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Në RVB dhe gjatë vizitave në institucion nuk pati referenca të posaçme për stafin ndihmës/administrativ. Mungojnë të dhëna lidhur me profilin e tyre.

Referenca e vetme është Neni 63 i Statutit, sipas të cilit personeli ndihmës/akademik ndahet në: a) personeli ndihmës/akademik me karakter mësimor dhe b) ndihmës/akademik me karakter administrativ.

a. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose kërkimit shkencor. Ai bën pjesë në stafin e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Këtu përfshihen laborantët, teknikët etj, sipas përcaktimeve të bëra në aktet e brendshme të institucionit.

b. Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel të institucionit. Këtu përfshihet personeli i përcaktuar në aktet e brendshme të institucionit.

2. Kriteret e punësimit të personelit ndihmës-akademik, me kohë të plotë, propozohen nga njësi e cilës ky personeli i shërben, konkursi drejtohet nga një komision ad-hoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë përkatëse.

3. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit ad-hoc, si dhe të përzgjedhjes së personelit ndihmës-akademik caktohen në aktet e brendshme të institucionit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Ashtu sikurse përcaktohet në dokumentat themeltarë të KUB, personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit njohin përgjegjësitë e tyre në angazhimin për plotësimin e objektivave të programit përkatës të studimit.</p> <p>Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmbushjen e objektivave të strategjisë së zhvillimit të institucionit.</p>
<p>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik është përgjegjësi kryesor për organizimin e programeve të studimit dhe për këtë aktivizohet në mënyrë të veçantë Këshilli Shkencor i programit, ose ngrihen komisione Ad Hoc, sipas nevojave të caktuara.</p> <p>Rekrutimi i personelit të ri bëhet me kërkesë nga vetë njësia bazë sipas nevojave në programe të caktuara dhe procesi zhvillohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>KUB ndjek hapat e duhur ligjorë për rekrutimin e personelit akademik, përmes një procesi të qartë me 5 hapa, të cilët përfshijnë: nxjerrjen e thirrjes së hapur për personel akademik; dorëzimin e dosjes për ndjekje nga Zyra e Burimeve Njerëzore; vlerësimin e dosjes nga Departamenti dhe përcjelljes e vendimit për kandidaturën fituese në Rektorat; vendimin e Rektorit për ndjekje të procedurave në vijim nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe përgatitjen e emërimit dhe shpalljen e kandidatit fitues dhe prezantimin e tij/saj te stafi akademik.</p> <p>Ngarkesa mësimore për këtë vit akademik realizohet në masën e kërkuar, 72% nga personel akademik i punësuar me kohë të plotë.</p> <p>KUB bën në mënyrë të vazhdueshme vlerësimin e personelit dhe e realizon këtë proces në mënyrë transparente.</p> <p>Institucioni ka një arkivë të plotë të gjithë lëvizjeve të stafit akademik dhe mbështetës ndër vite.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p>	<p>Përgjegjësi i programit ka gradën shkencore Dr. të fituar pranë Universitetit të Tiranës gjë e cila e bën këtë kriter të paplotësuar .</p> <p>Sipas raportimeve në RVB dhe pas shqyrtimeve të dokumentacionit mbështetës, u konstatua se titullarët e lëndëve kanë të paktën gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Edukimit ka siguruar një personel të mjaftueshëm akademik, i cili të mund të ndjekë dhe drejtojë studentët përgjatë praktikave profesionale.</p>

<p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Sikurse parashikohet edhe në ‘rregulloren e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”, “bashkërenduesi i programit përkatës i propozon Dekanatit të Fakultetit një udhëheqës teze për çdo student në fillim të semestrit të tretë dhe temën e tezës së përcaktuar nga udhëheqësi në fillim të semestrit të fundit.”.</p> <p>Ashtu sikurse është përcaktuar në rregulloren e sipërcituar, “Udhëheqësi i tezës përzgjidhet nga personeli akademik me të paktën gradën “Doktor”. Në rast se ka pamjaftueshmëri në numër të këtij personeli të caktuar akademik, atëherë mund të zgjidhen nga personeli akademik i departamenteve të ngjashme, me të paktën gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Sipas RVB, neni 16 i Rregullores së programit të studimit, përcakton që Udhëheqësi nuk mund të mbikëqyrë më shumë se 10 studentë në të njëjtën kohë. Gjatë shqyrtimit të dokumentit të sipërcituar, neni 16 është “Vlerësimi i pranimit” dhe shprehet për pranimin e studentëve dhe jo për temat kërkimore. Gjithsesi, ashtu si referon edhe vetë RVB, udhëheqësi zgjidhet në përshtatje në fushën e kërkimit, megjithë tejkalimin numrit prej 5 studentësh në mbikëqyrje, ashtu sikurse e parashikon kriteri përkatës.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>GVJ konstaton se nga Institucioni bëhet kujdes që fusha e ekspertizës së udhëheqësit të përputhet me temën kërkimore për të cilën është i interesuar studenti. Gjithashtu konstatohet se udhëheqësi ka njohuri dhe aftësi kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ konstatoi një përkushtim maksimal të personelit ndihmës për të lehtësuar studentët në përdorimin e mjediseve shkollore.</p> <p>Stafi i KUB është plotësisht i angazhuar për të realizuar objektivat e programit. Megjithatë, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ka mbingarkesë të stafit akademik por mesa na komunikuan wshtw e pwrballueshme.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore sipas përcaktimeve ligjore.</p> <p>Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore, ashtu sikurse është paraqitur në RVB dhe ashtu sikurse u konfirmuar nga vizita e GBJ në KUB.</p>

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Institucioni disponon dosje të kompletuara me një bazë të plotë të dhënash të trupës mësimore, me kohë të plotë dhe kontrata pune. Të dhënat e anëtarëve të personelit akademik përkojnë me objektivat dhe misionin për realizimin e programit të studimit. Nga studimi i dosjes së personit përgjegjës për programin e studimit rezulton se ka gradën Dr, si dhe të dhënat e kërkuara për këtë pozicion janë në përputhje me kërkesat për realizimin e programit Msc në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji".

KU"Bedër" disponon një listë të plotë të stafit akademik dhe administrativ të miratuar nga Senati akademik. Verifikimi nga ana jonë e kësaj liste dëshmon përputhjen e programeve të studimit me listën e personelit të punësuar në këtë institucion.

Konstatuam se rekrutimi i personelit akademik kryhet me procedura të rregullta me transparencë dhe objektivitet. Njoftimet për vendet e reja si dhe rezultatet pas konkurimit shpallen në faqen online të institucionit dhe janë të dokumentuara në dosjet e personelit.

Konkluzionet e vlerësimit:

KUB ka një vëmendje të veçantë ndaj personelit akademik, mësimdhënies dhe rritjes profesionale të vetë personelit.

Njësia bazë është përgjegjësi kryesor i të gjithë procesit të rekrutimit të personelit akademik, duke përfshirë: vlerësimin e nevojave për personel të ri akademik (efektiv ose me kontratë), përcaktimin e kriterëve të kandidatave të përshtatshme; realizimin e procesit të njoftimit (në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore), përcaktimin e kandidatave fituese dhe prezantimin e personelit të ri në stafin e KUB.

KUB zotëron një bazë të dhënash të plotë lidhur me lëvizjet e personelit akademik ndër vite dhe detaje lidhur me karakteristikat e formimit të tyre akademik dhe profesional.

Studentwt, gjatë punimit të tyre të diplomës, ndiqen në mënyrë të specializuar nga udhëheqës me të paktën gradën shkencore "Doktor".

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Mbështetur në të dhënat e deklaruara në RVB, GVJ konstaton se KU"Bedër" ka një një mjedis prej 5628 m2 të ndarë në dy godina : Godina A është 8 katëshe dhe aty ndodhen sallat ku zhvillohet mësim, muzeu, salla e gjyqit, laborator i informatikës, biblioteka, mjediset për shërbime studentare, dhe shëndetësore. Godina B është 2 kateshe, ku krahas klasave ka ambjente për zhvillimin e karrierës dhe të aktiviteteve ekstrakurrikulare si dhe ambjenti i paletës që shfrytëzohet nga studentët dhe stafi për aktivitete sportive.

Godinat kanë një infrastrukturë me ngrohje, janë të pajisura me vidioprojektore, tabela inteligjente për zhvillimin e procesit mësimor. Institucioni ve ne dispozicion 8.1m2 për cdo student si dhe 1 libër për 15 studentë.

Institucioni ka plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme për ndricim natyral, për ngrohje edhe me alternativë, dalje si dhe shkallë emergjence. ka sistem mbrojtje kundra zjarrit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione	4	358
Klasa për seminare	13	686
Salla për aktivitete promovuese	1	268.6
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	1	25
Laboratorë për lëndët	1	350
Laboratorë informatike	1	44.6
Salla interneti	1	40
Salla për bibliotekë	1	230
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	16
Zyrë informacioni për studentët	3	75
Korridore/holle	25	1807.7
Mjedise sportive	1	150
Mjedise shërbimi për të tretë	1	40
Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore	1	32
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj	1	80
Nyje hidrosanitare për studentët	38	171
Etj....		370
Norma m²/për student	8.1	

Mjediset për stafin:

Mjedise për Dekanin/ kancelarin	4
Zyra për sekretarinë mësimore	1
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	6
Zyra për personelin akademik	16

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	KUB e zhvillon aktivitetin e tij në një godinë, në të cilën zhvillohen në mënyrë të përhershme si aktiviteti mësimor ashtu edhe ai administrativ.
Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Këto mjedise kanë qenë në dispozicion të KUB prej të paktën 6 vjetësh.
Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e	Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji ofrohet në një godinë, e cila është e pajisur me të gjithë logjistikën e nevojshme për

<p>politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>zotërimin e standardeve për realizimin e programit Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji.</p> <p>Lidhur me realizimin e praktikave të këtij programi studimi, referuar RVB si dhe informacioneve të vëna në dispozicion nga studentët në takimet e organizuara në institucion rezulton se për zhvillimin e praktikave profesionale institucioni ka nënshkruar marrëveshje me DAR-Tiranë, Lezhë, me institucionet e edukimit të Turgut Ozal si dhe me sh.p.k Gulistan. Po kështu ka mundësuar zhvillimin e praktikave profesionale pranë zyrave të institucionit si ato të Burimeve Njerzore, Zyrës së Zhvillimit të Karrierës. Po kështu studentët na informuan se kanë asistuar në projektet e Zyrës së kërkimit shkencor. RVB pasqyron kapacitete të mjaftueshme të KUB për realizimin e praktikave mësimore për programe të studimit të shkencave teknike.</p>
--	--

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Nga RVB-ja dhe vizita në institucion e KU “Beder” pamë një bibliotekë efikase dhe me tekste bashkëkohore. Shumica e teksteve të detyrueshëm për programin e studimit ishin në bibliotekë kurse për literaturën shtesë mund ta aksesonin në bibliotekën online.</p> <p>Stafi akademik dhe studentet kanë në dispozicion një fond prej 36000 titujsh të bibliotekës dhe një numër të madh titujsh botimesh shkencore, revistash periodike e cila vjen duke u pasuruar vazhdimisht në përmbushje të kërkesave të departamenteve dhe nevojave për një informacion sa më bashkëkohor.</p> <p>Nga vizita në bibliotekë konstatoam zotërimin e një numri të madh të botimeve periodike në fushën e psikologjisë dhe të pedagogjisë. Biblioteka e KUB ka një sistem të automatizuar të punës me literaturën, të instaluar për regjistrim dhe kërkim nga ana e studentëve. Kjo gjë mundësohet nga abonimi që është bërë në sistemin EBSCO Host që i ofron studentëve të kenë akses për 45 000 tituj librash dhe 5000 revista.</p> <p>Biblioteka e KU”Beder” mundëson komunikimin edhe në Book Academic collection.</p> <p>Biblioteka ka vënë në dispozicion të studentëve të Masterit në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” një numër titujsh tekstesh, në mbështetje të programit dhe buxhetit të planifikuar nga institucioni si dhe një sërë monografish, revistash të cilat përmbajnë informacionin e duhur dhe për përgatitjen e punimeve me karakter shkencor dhe temave të diplomës. Nga RVB dhe komunikimi me studentët në bibliotekë u njohëm me projektin studentor “Unë dhuroj, dhuro dhe ti” për grumbullimin e librave dhe pasurimin e bibliotekës me një numur prej 10000 mijë librash.</p> <p>Biblioteka shërbente nga e hëna në të shtunën me orare te pershtashme (08:30-19:00) për studentët dhe pedagogët, dhe ka ambiente optimale të cilat sigurojnë kushte për studim.</p>
--	---

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Referuar RVB si dhe vizitës në institucion konstatuam se: Institucioni ofron mjedise të mjaftueshme për realizimin e programit mësimor si qendra e medias dhe komunikimit, laboratorin e gjuhëve të huaja, laboratorin e informatikës, sallë gjyqi për zhvillimin e praktikave profesionale si dhe pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit të cila vihen në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve në realizimin e programit mësimor.</p> <p>Në përputhje me programet mësimore intitucioni ka vënë në dispozicion pajisjet qe plotësojnë në mënyrë funksionale mjediset për mësimdhënie të tilla si derrasa interactive, kompjutera, internet si dhe salla të pajisura dhe me ndricim dhe ngrohje të pershtatshme.</p> <p>Në programin Master i Shkencave në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” i ofruar për riakreditim nuk janë parashikuar punë laboratorike për vet specifikën që ka programi.</p> <p>Institucioni në realizimin e këtij programi ka vene në dipozicion Qendrën e Medias dhe Komunikimit si dhe Sallën e Gjyqit ku janë organizuar seanca praktike në përputhje me programet lëndore.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Institucioni ofron mjedise të mjaftueshme për realizimin e programit mësimor si dhe qendra e medias dhe komunikimit, laboratorin e gjuhëve të huaja, laboratorin e informatikës, sallë gjyqi për zhvillimin e praktikave profesionale.

Në përputhje me programet mësimore intitucioni ka vënë në dispozicion pajisjet qe plotësojnë në mënyrë funksionale procesin e mësimdhënies.

Referuar RVB si dhe informacioneve të vëna në dispozicion nga studentet në takimet e organizuara rezulton se për zhvillimin e praktikave profesionale institucioni ka nënshkruar marrëveshje, kryesisht me institucionet e edukimit.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Për këtë rubrikë, GVJ është mbështetur në të dhënat e deklaruara nga RVB si edhe në dokumentacionin shoqërues të këtij raporti.

Burimet e financimit të institucioni janë pagesat e studentëve dhe donacionet. Mbështetur në legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, institucioni ka të drejtë të pranojë mbështetje financiare dhe materiale në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij.

Kostoja për student për vitin akademik është si më poshtë:

2013-2014 ishin 177,066 ALL, 2014-2015 ishin 210,543 lekë, 2015-2016 ishin 215, 763 lekë, 2016-2017 ishin 165,449 dhe 2017-2018 ishin 153,619 lekë.

Institucioni kontrollohet në mënyrë të rregullt nga institucionet shtetërore financiare, mban kontabilitet të rregullt dhe mer ndihmen e nevojshme për probleme tatimore, kontabiliteti nga eksperte të jashtëm financiarë.

KU”Beder” është në menaxhimin financiar të Fondacionit Hafiz Ali Korca.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

Grantet për kërkim për vitin 2013-2014 është 206,000 dhe për vitin 2016-2017 është 1,312,193.

Konsulencat, shërbimet për 2013-2014 është 1,216.000 dhe për vitin 2015-2016 është 2,176,640, 2016-2017 është 166,652, për 2017-2018 është 9,027,774 dhe për 2018-2019 është 376,050.

Tarifat për dhe gjatë shkollimit 2013-2014 është 69,279,180; 2014-2015 është 72,676,750; 2015-2016 është 85,746,511; për 2016-2017 është 81,141,671; 2017-2018 është 64,625,526 dhe për 2018-2019 është 28,011,220.

Sponsorizime nuk ka.

Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) nuk ka.

Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj: 2013-2014 është 48,463,997; për 2014-2015 është 97,021,093; për 2015-2016 është 72,079,844; për 2016-2017 është 33,359,263; për 2017-2018 është 28,350,000 dhe për 2018-2019 është 1,224,600.

Aktivitetet tregtare (mensa, kafë, bare, residencat, etj) nuk ka.

- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Shpenzimet për student për vitin akademik është si më poshtë:

2013-2014 ishin 177,066 ALL, 2014-2015 ishin 210,543 lekë, 2015-2016 ishin 215,763 lekë, 2016-2017 ishin 165,449 dhe 2017-2018 ishin 153,619 lekë.

Mbështetur në të dhënat e mësipërme rezulton se shpenzimet për studentët nga viti 2016 kanë ardhur në ulje.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Ashtu siç është e paraqitur edhe në RVB, mbështetur në legjislacionin në fuqi institucioni bën auditimin e situatës financiare me ekspertë të jashtëm dhe harton raporte financiare ku pasqyrohen të ardhurat nga tarifat e shkollimit, kontributeve të tjera financiare dhe e shpenzimeve. Raporti financiar bëhet çdo vit. Një kopje i vihet në dispozicion MASR.</p> <p>Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj. Eksperti i auditit konstaton se burimet financiare dhe përdorimi i tyre bëhet në bazë të një programi financiar i hartuar në përputhje me standartet kombëtare të hartimit të raportimit KU"Bedër"ka mbështetjen e donatorëve dhe ka kapacitete të mjaftueshme financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për të ardhmen. Zhvillimi i programit të studimit Master i Shkencave në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji ka mbështetjen financiare të institucionit.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishtme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Bazur në RVB konstatohet se për çdo vit kalendarik hartohen pasqyrat financiare në zbatim të standardeve të kontabilitetit dhe të ligjit përkatës.</p> <p>Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj. Zyra e financës dokumenton raportet vjetore financiare për tre vitet e kaluara. Konstatuam se gjendja financiare paraqitet e qëndrueshme me kapacitete financiare të mjaftueshme për të garantuar ecurinë normale të programeve të studimit.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>Institucioni kryen veprimtarine financiare në përputhje me detyrimet ligjore dhe nën ligjore në fuqi dhe përgatit raporte financiare vjetore për të gjitha njësitë.</p>	

KU "Beder" dokumenton aktivitetin financiar nëpërmjet pasqyrave financiare vjetore dhe auditimit të përvitshëm të llogarive të tij, nga ekspertë kontabël të rregjistruar.

Gjendja financiare e institucionit është në parametra optimale dhe mundëson përmirësimin e mëtejshëm të parametrave për rritjen cilësore të mësimdhënies dhe përmirësim të shërbimeve për çdo student.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Bazuar në RVB, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe Komisioni i Përhershëm për garantimin e standarteve të sigurisë institucionale në KU "Beder" janë ngritur sipas standarteve të përcaktuara nga MASR. Ajo e ushtron aktivitetin e saj dhe është përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore, kërkimore-shkencore dhe i raporton drejtpërdrejtë Rektorit. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) përbëhet nga pesë anëtarë nga të cilët tre janë pjestarë të stafit akademik me kohë të plotë, një ekspert i jashtëm dhe një student (Shiko Anekse, tabela 5). Në takimin me përfaqësuesit e NJBSC, GVJ mori informacion për mënyrat se si funksionon kjo njësi në KU "Beder". NJBSC ka një sërë kompetencash në lidhje me politikën, procedurat, vlerësimet e programeve etj.

Pas çdo vlerësimi raporton rezultatet dhe bën propozimet përkatëse para Senatit Akademik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë

Mbështetur në informacionin e RVB në institucion janë realizuar 12 anketime me studentët.

- Sa studentë janë anketuar?

Janë ftuar të marrin pjesë në anketim të gjithë studentët e programeve të studimeve.

- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë?

Nëpërmjet anketimeve kanë dalë probleme për infrastrukturën, logjistikën si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve.

Pasi janë konstatuar problemet, ashtu sikurse deklarohet në RVB si dhe nga informacioni i dhënë nga drejtuesit e institucionit, rezulton se nga ana e institucionit po merren masat për përmirësimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në institucion ka si funksion kryesor garantimin e cilësisë, përmirësimin e vazhdueshëm të saj, në arritjen e objektivave të përcaktuara. Procedurat e vlerësimit organizohen sipas një rregulloreje të brendshme të institucionit, e cila përfshin vlerësimet e studentëve për stafin akademik dhe stafin administrative si dhe vetëvlerësimet e stafit akademik. Të gjitha përfundimet e marra nga këto tre burime, analizohen me qëllim nxjerrjen e përfundimeve për situatën aktuale si dhe për përpilimin e sugjerimeve për përmirësimin e situatës në vijim.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti.

Bazuar në RVB dhe në takimet e realizuara me përfaqësuesit e kësaj zyre, garantimi dhe rritja e vazhdueshme e cilësisë nuk është vetëm detyrë e NJBSC, por e rëndësishme është të krijohet dhe zhvillohet kultura e cilësisë në çdo njësi të funksionimit akademik dhe administrativ të KU "Beder". Ngritja e GVB pranë Fakulteteve,

përfshirja në to edhe e studentëve i shërben pikërisht këtij synimi. NJBSC monitoron dhe menaxhon profesionalisht cilësinë duke bashkëpunuar me GVB të fakulteteve. Në takimin me NJBSC, u konstatua se monitorimi dhe menaxhimi i cilësisë shkonte deri në nivel departamenti.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetëvlerësimet janë vjetore dhe kryhen nga NJSBC. Ato shërbejnë për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të marrë masat e nevojshme të përmirësimit të saj. GVJ u njoh me rezultatet e vetëvlerësimeve në vitin akademik 2017-2018.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Referuar RVB si dhe nga informacionet e mara në takimin me stafin akademik rezultoi se programi i studimit është vlerësuar nga anketat e studentëve si dhe nga stafi i brendshëm. Gjithsesi sipas RVB, në të ardhmen NJBSC nëpërmjet GVB-ve do të realizojë ndjekjen sistematike të vazhdimësisë së programit duke patur në fokus përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi L.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të 	<p>Në strukturën e organizimit të KU "Beder" ushtron veprimtarinë Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, e cila është pjesë e strukturës së organizimit të KU "Beder".</p> <p>Kjo Njësi e ushtron veprimtarinë e saj si njësi e përhershme dhe ka për detyrë të vlerësojë ecurinë e programeve të studimit nëpërmjet një metodologjie vlerësimi dhe instrumentave matës dhe vlerësues, të cilat janë:</p> <p>Sondazhet e studentëve që ndjekin programet studimore, të cilët në përfundim të ciklit të studimit, nëpërmjet pyetësorëve, japin opinionet e tyre për cilësinë e mësimdhënies, cilësinë e programeve, teksteve, etj.</p> <p>Përfundimet e dala nga pyetësorët për studentët, të cilët plotësohen në fund të semestrave dhe japin informacion për aftësitë profesionale të pedagogëve, cilësinë e komunikimit në auditore, përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie dhe praktika mësimore si dhe përfundimet e dala nga intervistat me kampione studentësh ose fokus-grupe për secilin program studimi, i përcillen Senatit të KUB për t'i bërë pjesë integrale të procesit të vetëvlerësimit dhe, në vijim të përmirësimit në të ardhmen.</p> <p>Përfundimet e këtij vlerësimi bëhen publike në mënyrë transparente dhe të vazhdueshme.</p> <p>Sondazhe të studentëve të cilët kanë përfunduar programin e studimit. Nëpërmjet këtyre sondazheve me studentet "Alumni", njësia arrin të mbledhë një informacionin të nevojshëm mbi nivelin e arritur. NJBSC përpunon të dhënat e grumbulluara, rezultatet e të cilave i vihen në dispozicion, në mënyrë konfidenciale, stafit akademik .</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit NJBSC përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta</p> <ul style="list-style-type: none"> Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, lëndëve/kurrikulës, dhe të të mësuarit. <p>Të drejtpërdrejta</p>

<p>analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Dëgjime në auditor të cilat realizohen nga shefi i departamentit dhe nje anëtar i NJSCB; • Rezultatet e arritura nga studentët bazuar në provimet e vlerësuara me nota ose pikë; • Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare. <p>Bazuar në këtë metodologji, GVJ Ju komunikua se Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë ka arritur në përfundimin se: Programi Master i Shkencave në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”, e cila ofrohet nga institucioni KU “Beder”, duhet të jetë e mirëorientuar ndaj kërkesave për procedurat e nevojshme për punësim.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Puna e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë së bashku me elementë përbërës të praktikave të punës së saj dhe përfundime të vlerësimeve periodike që ajo kryen, publikohen përmes mjeteve të ndryshme të informimit publik, të cilat botohen nga institucioni në formatin e printuar.</p> <p>Gjithashtu KUB në mënyrë të vazhdueshme publikon vlerësimet e kryera nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në formatin digjital, duke mundësuar edhe një nivel të lartë transparence.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>KUB përmes Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit, ndër të cilët edhe për programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”.</p> <p>Këto analiza vjetore i përcillen Departamenteve, të cilat mundësojnë edhe përmirësimin në fushën përkatëse.</p>
<p>sStandardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar në vitin 2013 nga APAAL dhe në vitin 2017 nga Agjensia Britanike e Akreditimit “Quality Assurance Agency” në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>Referuar RVB konstatojmë se pranë KU “Beder” përdor Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe dy komisione të përhershme si: Komisioni i përhershëm i kërkimit shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionet si dhe Komisionin për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.</p> <p>Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik.</p> <p>Ky funksion primar realizohet i përqëndruar kryesisht nga një strukturë e mirëorganizuar dhe operative sikurse është NJBSC, e cila në punën e saj përdor metoda për kontrollin e cilësisë dhe mbikëqyrjen e saj. Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik.</p> <p>Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë, së bashku me njësitë e tjera të institucionit, ushtron kontroll të vazhdueshëm për cilësinë e mësimdhënies në të gjithë komponentët e veprimtarisë mësimore e shkencore.</p> <p>Kjo njësi bën vlerësimin e programeve studimore duke u përqëndruar kryesisht tek Syllabuset, me synimin që ato të mos interferojnë me disiplina të tjera, por të realizojnë lidhje ndërdisiplinore. Në lidhje me përputhshmërinë e literaturës me programin, shikohet nëse ka nivel shkencor të kohës,</p>

	<p>përshatet me nivelin e dijeve dhe aftësive të studentëve. Në rastet kur studentët kanë stade të avancuara, kërkohet pasurimi i literaturës me tituj të rinj, me qëllim që të rriten aftësitë dhe niveli shkencor i dijeve të studenteve.</p> <p>Senati i institucionit, merr në analizë praktika të testimit të cilësisë së programeve të studimit të disiplinave të ndryshme dhe të veprimtarive me karakter mesimor-shkencor.</p> <p>Institucioni për ndërgjegjësimin e personelit dhe të studentëve ve në dispozicion Manualin e Sigurimit të Cilësisë si dhe Guida për Studentët ku evidentohe qartë rëndësia e cilësisë dhe sigurimi i saj në funksion të kërkimit shkencor dhe të përmirësimit të mësimdhënies.</p> <p>KU "Bedër", sipas RVB, ka hartuar dhe zbaton që në vitin 2012 planin strategjik 5- vjeçar në përmbushje të misionit të institucionit. U vumë në dije se aktualisht është hartuar një plan i ri strategjik 2018-2023 i cili ndodhet në Dosjen e Vetvlerësimit si dokument sw bashku me planin strategjik institucional 2013-2017.Strategjia, politika dhe procedurat janë të aksesueshme në faqen e institucionit Bedër.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

KU "Beder" realizon sigurimin dhe mbikqyrjen e cilësisë në përputhje me standartet e kërkuara duke përdorur në mënyrë të vazhdueshme instrumenta të matjes dhe të vlerësimit si intervista, anketime etj.

Njesia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë KU"Bedër" i ka krijuar mekanizmat e nevojshëm institucionalë për të garantuar cilësinë. Konstatuam se kjo njësi është funksionale dhe e mirëingranuar në kontrollin e mbikqyrjen e cilësisë dhe kontribuon duke dhënë sugjerime dhe rekomandime për Senatin Akademik.

Kjo njësi bën vlerësimin e programeve të studimeve duke u përqendruar kryesisht në Syllabuset, me synimin që syllabuset e programeve të ndryshme të mos interferojnë midis tyre, por të realizojnë lidhje ndërdisiplinore.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj.

Sikurse është paraqitur edhe në RVB dhe në dokumentacionin mbështetës të këtij raporti (Evidenca nr. 15) "Rregullore e studimeve të ciklit të dytë në Master i Shkencave në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji", në Nenin 4 "Organizimi i studimeve", përcaktohet se studimet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në programin e studimit Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji zhvillohen në sistemin me kohë të plotë. Programi i studimeve realizohet me 120 ECTS, në përputhje me planin mësimor propozuar nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe vendim i Këshillit të Dekanatit të Fakultetit dhe miratur me vendim të Senatit Akademik të Kolegjit Universitar - "BEDËR". Sipas Nenit Nr 5 të Rregullores së programit të studimit (Evidenca Nr 15) gjuha e studimit në këtë program studimi është Gjuha angleze.

Programi i studimit përbëhet nga 14 lëndë dhe teza e diplomës, e cila zhvillohet në përfundim të programeve të studimit të ciklit të dytë.

Në një vit akademik realizohen të paktën 60 kredi ECTS.

1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve.

1 semestër ka 16 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve.

1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit.

1 orë mësimore = 50 minuta.

Studenti realizon çdo vit jo më pak se 1500 orë pune.

Programi organizohet në dy vite akademikë, i ndarë në katër semestra.

Një vit akademik ka 60 ECTS.

Procesi mësimor përbëhet nga leksionet dhe seminarët të cilat jepen në mënyrë të integruar, projektet/detyra, dhe punime të tjera të ngjashme të parashikuara në programin mësimor.

Vlerësimi nga pikëpamja akademike për leksionet/seminarët, projektet/detyra, dhe punime të tjera të ngjashme bëhet në bazë të njësisë matëse orë të zhvilluar në auditor. Vlera e krediteve të një lëndë përbëhet nga shuma e të gjithë orëve javore të leksioneve teorike javore dhe sa gjysma e orëve javore të aplikimeve, laboratoreve, projekteve dhe punës në atelje. Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e provimeve semestrale/vjetore; provimeve të fundvitit; detyrave të kursit; prezantimeve; aktivizimeve dhe projekteve. Me propozim të drejtuesit të programit përkatës dhe vendim të Komitetit Shkencor, studentit i jepet e drejta të hyjë në provim nëse nuk ka hyrë gjatë vitit për shkak të arsyeshme dhe të dokumentuara brenda tre ditëve.

Neni 11 i “Rregullores së studimeve të ciklit të dytë në Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”, sa i takon politikave të Frekuentimit parashikon që “Studenti në program ka detyrimin të ndjekë të paktën 70% të aktiviteteve mësimore kërkimore të zhvilluara në auditor të lëndëve teorike dhe të aktiviteteve mësimore kërkimore. Studentët, të cilët tejkalojnë këto norma, duhet ta rimarrin përsëri atë lëndë me të gjitha detyrimet përkatëse. Plotësimi apo jo i kushteve në lidhje me pjesëmarrjen, i paraqitet koordinatorit të programit nga ana e pedagogut të lëndës çdo muaj dhe kontrollohet nga Përgjegjësi i Departamentit.”.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e programit të studimit

Programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji u licensua në vitin akademik 2012-2013. Duke u mbështetur në RVB nuk ka të dhëna për studentët të regjistruar gjatë vitit të parë të ofrimit të këtij programi deri në licensimin e tij.

Vizioni i këtij programi është sjellja e një risie në mënyrën e aftësisë dhe të përgatitjes së studentëve nëpërmjet një gërshetimi të mirëorganizuar të anës teorike me praktikën në kushte dhe mundësi fizike bashkëkohore.

Programi Master i Shkencave në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” synon zhvillimin dhe transferimin e njohurive në fushën e Psikologjisë dhe Pedagogjisë përmes shqyrtimit teorik dhe kritik të krijimeve historike, filozofike, sociologjike, pedagogjike dhe praktikës së shërbimit psikologjik nëpër shkolla.

Objektivat formuese të programit janë parashtruar në Nenin 3 të Rregullores së studimeve të ciklit të dytë, Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji.

Pas shqyrtimit të RVB, rregullores së studimeve si dhe në takimet me stafin akademik dhe vetë studentët, një ndër objektivat kryesorë të këtij programi është përgatitja e profesionistëve të aftë për të punuar në fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë. Një tjetër objektivi është përgatitja e profesionistëve për të punuar në profesionin e psikologut.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Mbështetur në RVB si dhe në verifikimin e dokumentacionit që shoqëron këtë raport, rezultojnë se:

➤ 1 vit akademik ka	32 javë mësimore në auditor
➤ 1 Semestër ka	16 javë mësimore në auditor
➤ 1 ECTS	25 orë mësimore punë të studentit
➤ 1 orë mësimore	50 minuta

- Plani mësimor i detajuar paraqitet në Anekse, Tabela 6
- Plani mësimor i kërkuar si dokument gjatë vizitës në Institucion të GVJ i riorganizuar por akoma i pa miratuar nga MASR, paraqitet në Anekse, Tabela 7. Siç edhe mund të dallohet lehtë në këtë plan, gjuha mësimore e cila është kërkuar të ofrohet për këtë program studimi, do të jetë gjuha shqipe dhe jo angleze.
- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:
- Për leksionet 672 orë në auditor dhe 308 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Seminarët 608 orë në auditor dhe 588 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Praktikën Profesionale 80 orë në auditor dhe 84 orë punë e pavarur e studentit
 - Provimi përfundimtar 320 orë në auditor dhe 430 orë punë e pavarur e studentit

Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese paraqitet në Anekse, tabela nr 8. Sic edhe shikohet ndarja e veprimtarive formuese është nga A në F dhe Jo nga A në E siç e përcakton edhe VKM Nr 41, dt 24.01.2018

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Sikurse paraqitet në dokumentacionin shtesë, në shkresën “Evidenca Shtesë: Kërkesa për hapjen dhe riorganizimin e programeve të reja”, në shkresën dërguar Ministres së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë “Kërkesë për riorganizimin e 6 (gjashtë) programeve”, Nr 99/1 Prot, datë 29.10.2017, KUB ka kërkuar miratimin për riorganizimin e gjashtë programeve të studimit, ndër të cilat edhe Masterin e Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji.

Në RVB nuk ka asnjë referencë ndaj kësaj korrespondence me MASR për riorganizimin e programit Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji dhe në dokumentin bashkëngjitur RVB “Evidenca Shtesë: Plani mësimor i programit dërguar për ri-organizim”, nuk paraqitet skema e ndryshimit të programit fillestar.

Gjithsesi nuk ka një kërkesë për riorganizim sipas VKM nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, sipas shtojcës 1.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës janë paraqitur në Anekse. Për këto plane të lidhura me personelin përkatës mësimdhënës ndër vite, Lutem referojuni edhe Rubrikës Nr 3 të këtij Raporti.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetësimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset përgatiten nga pedagogu i lëndës dhe ka në përmbajtjen e tij të gjithë elementët përbërës, duke filluar nga objektivat e lëndës deri në literaturën përkatëse (përfshirë detaje lidhur me vlerësimin).

Studenti njihet me syllabusin në javën e parë mësimore dhe ka mundësi ta aksesojë syllabusin në faqen zyrtare të KUB.

Ashtu sikurse përshkruhet në RVB dhe paraqitet edhe në syllabuset që kanë shoqëruar RVB, struktura e tyre është e ndërtuar me këto elementë:

Përshkrim të orëve javore; numrin përkatës të krediteve; grupin e lëndëve të cilës i përket; objektivat e lëndës; detyrimet e studentit përgjatë semestrit; format e vlerësimit dhe literaturën.

Syllabuset kanë një strukturë të plotë, standarde dhe janë lehtësisht të aksesueshëm.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është akredituar për herë të parë dhe tashmë po i nënshtrohet akreditimit periodik të tij. Ky Plan është organizuar në dy vite akademike dhe i vlerësuar me 120 kredite, në përputhje të plotë me Sistemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është i organizuar në katër semestra dhe çdo vit akademik është i vlerësuar me 60 kredite në total.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji, pas përfundimit me sukses të të gjithë detyrimeve në të gjitha lëndët, e pajis studentin me diplomën “Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”, duke e pajisur me njohuri dhe aftësi praktike si dhe me njohuri të thelluara në kërkimin shkencor.</p> <p>Programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji synon të zgjerojë njohuritë e marra në ciklin e parë të studimeve. Njësia bazë, Departamenti i Shkencave të Edukimit në KUB, ofron edhe programin Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji.</p> <p>Programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji ka si një ndër synimet e tij madhore pajisjen e studentit me njohuri dhe kompetenca profesionale të cilat do të arrijnë të zgjerohen përgjatë gjithë ecurisë së programit.</p> <p>Me lëndë të cilat kanë si fokus të tyre njohuritë lidhur me kërkimin shkencor, Programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji shërben si një bazë e mirë për pranimin në ciklin e tretë të studimeve.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Objektivat e programit Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji janë hartuar në përputhje me nivelin e studimeve të cilit ky program i përket.</p> <p>Metodat e vlerësimit dhe format e ndryshme të kontrollit të dijeve me një shtrirje përgjatë gjithë semestrit si dhe përmes metodave të alternuara të vlerësimit të dijeve dhe aftësive, arrijnë të përcaktojnë në mënyrë të përshtatshme nivelin e përvetësimit të dijeve nga ana e studentëve.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Ashtu sikurse u deklarua përgjatë takimeve me GVB dhe stafin akademik, ky program studimi është hartuar mbi një program të ngjashëm në Turqi dhe përgjatë viteve është zhvilluar përmes përvojës të sjellë nga stafi akademik i angazhuar në këtë program.</p> <p>Programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është një program ndërkombëtarisht konkurrues sa i takon strukturës lëndore dhe sistemit ECTS.</p> <p>Programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë, <u>por nuk është i riorganizuar sipas VKM nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”</u>. Gjithashtu, <u>ky program bie ndesh me përcaktimet ligjore që rregullojnë profesionet e rregulluara të Psikologut dhe të Mësuesit</u>.</p> <p>(Nuk përputhet me përcaktimet ligjore për profesionet e rregulluara në: 1) Ligjin nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë; 2) Ligjin Nr. 40/2016, datë 26.05.2016 “Për urdhrin e psikologut në Republikën e Shqipërisë”; 3) Ligjin Nr. 48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>GVJ Konstaton se programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji:</p> <ul style="list-style-type: none"> - e formon studentin si në planin e aftësimin profesional ashtu edhe në drejtim të kërkimit shkencor. - është hartuar në përputhje të plotë me profilin e Kolegjeve Universitare si dhe me strategjinë e zhvillimit të institucionit - Personeli akademik i Programit Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është potësisht i angazhuar në realizimin e këtij programi studimi - Personeli akademik është përgjegjës për lëndë të cilat i përshtaten profilit të formimit të tyre akademik, por numri shumë më i madh i personelit akademik vijnë nga fusha e pedagogjisë, objektivi i formimit të profesionistëve të zotë në fushën e psikologjisë nuk përkon me realizimin e këtij synimi të sipërpërmendur.
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>NA</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji i përgjigjet nevojës për një prani gjithnjë e më të lartë të psikologëve tregun e punës, por nuk lehtëson punësimin e studentëve të diplomuar, për shkak të mosrespektimit të kuartit ligjor që rregullon licensimin e profesionit të psikologut në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Në RVB deklarohet se KUB dhe konkretisht Departamenti i Shkencave të edukimit ka kryer një studim të nevojave të tregut të punës në lidhje me këtë program, por ky studim tregu nuk gjendet në dokumentacionin mbështetës (si evidencë) të këtij raporti.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji nuk bie ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Ashtu sikurse përcaktohet në RVB dhe sikurse u konfirmua edhe gjatë vizitave në institucion, KUB ka bërë një përpjekje të vazhdueshme të ruajtje dhe promovojë kulturën kombëtare përmes përhapjes së kulturës tek studentët e huaj që studiojnë në KUB (edhe në këtë program). Gjithashtu KUB ka patur një vëmendje të rritur ndaj ruajtjes së vlerave kombëtare përmes programeve të bursave për studentë shqiptarë të ardhur nga trojet shqiptare jashtë kufijve të tilla si: Kosova, Lugina e Preshevës, etj.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është i hartuar në 4 semestra, çdonjëri prej të cilëve e vlefshëm për 30 kredite. Teza kërkimore është e vlefshme për 30 kredite. Kohëzgjatja normale e këtij programi studimi është 2 vjet.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Studentët njihen me programin e studimit në fillim të studimeve të tyre dhe me secilin nga syllabuset në fillim të çdo semestri. Në vijim, përgjatë gjithë kohës së studimeve të tyre në këtë program, studentët mund të vazhdojnë ta aksesojnë online informacionin lidhur me programin e studimit. Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Çdo student ndihmohet përmes Këshilltarit akademik të përzgjedhë temën e tij të diplomës. Në vijim studenti ka një udhëheqës dhe projekti kërkimor zhvillohet përmes një plani të caktuar diplomimi. Teza e programit Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është 30 kredite (ECTS).</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është i hartuar në përputhje me interesat kombëtare dhe ndjek në mënyrë harmonike nevojat e tregut të punës për një shtim të numrit të psikologëve. Nga ana tjetër, ky program studimi, duke qenë një program i ndërmjetës midis Psikologjisë dhe Pedagogjisë, nuk arrin të jetë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor që rregullon profesionet e rregulluara të psikologut dhe të mësuesit.</p> <p>Programi Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji zhvillohet në 2 vite, është i ndarë në 4 semestra dhe është i vlefshëm për 120 kredite. Teza e programit është 30 kredite.</p> <p>Syllabuset zotërojnë elementët e duhur për të orientuar dhe formuar studentët në lëndën përkatëse. Studentët kanë mundësi të aksesojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe transparente dokumentacionin e programit të studimit, si në formë të shkruar ashtu edhe elektronikisht.</p> <p>Stafi akademik është më së shumti i profilizuar në pedagogji, duke e vështirësuar realizimin e objektivit kryesor të programit që është formimi i psikologëve.</p>	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Procesi i mësimdhënies në KU “Beder” është organizuar në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e realizimit të programit mësimor Msc në “Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji”. Format e organizimit të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, projektet individuale dhe në grup, punimet kërkimore-shkencore si dhe kërkimi i literaturës në përshtatje me tematikën. Ky proces realizohet si rezultat i kombinimit dhe bashkërendimit të të gjitha formave gjatë procesit mësimdhënies.

Referuar RVB si dhe informacionit të grumbulluar në takim me stafin akademik dhe me grup studentësh rezulton se kombinimi i të gjitha formave të mësimdhënies rrit pavarësinë e mendimit dhe iniciativën për vetëpërimin.

Stafi i këtij institucioni na bëri me dije se në procesin e mësimdhënies, bashkëpunimi me ekspertë të fushave përmes leksioneve të hapura dhe shkëmbimit të eksperiencës në fushën e psikologjisë së këshillimit, ka përmirësuar në vazhdimësi procesin e mësimdhënies.

Studentët na deklaruan se format e kontrollit të dijeve kryen nëpërmjet testeve të ndërmjetme, detyra kursi, prezantime individuale ose në grup, projekte si dhe vlerësim për aktivizim të studentëve në procesin mësimor leksione/seminare.

Institucioni në funksion të realizimit të procesit mësimor ka realizuar procesin e mësimdhënies përmes teknologjisë së informacionit, nga Qendra e Medias dhe Komunikimit si dhe nga mbështetja me pajisje si me tabela interaktive (Smart Bord-e), kompjutera, porjektorë, etj.

Tërheqja e vazhdueshme e mendimeve të studentëve nëpërmjet anketimeve të kryera nga NJSBC për vlerësimin e metodave të mësimdhënies për secilin pedagog dhe lëndë ka bërë të mundur që departamentet të marrin masat e nevojshme për përmirësimin e mëtejshme të metodave të mësimdhënies.

Po kështu, referuar RVB, Këshilli i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore, mbështetur në problematikën e konstatuar dhe nevojat për përmirësim organizon trajnime me stafin akademik për të realizuar përmirësimin e metodave të mësimdhënies në fusha të caktuara ku paraqitet nevoja. Këto trajnime publikohen në faqen zyrtare të NJSBC.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet.

Në këtë program studimi format e organizimit të mësimdhënies janë: leksionet dhe seminarat. Programi nuk parashikon orë ushtrimesh, laboratorike apo praktikë lëndore por mundëson angazhimin e drejtpërdrejtë në praktikën profesionale.

Programi i Studimit Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	672
b.	Seminare	608
c.	Ushtrime	0
d.	Laboratore	0
e.	Praktikë lëndore	0
f.	Praktikë profesionale	80
g.	Të tjera	320
	Në total	1680

Format e kontrollit të njohurive

Mbështetur në RVB si dhe në konfirmimin e stafit akademik dhe të studentëve, format e kontrollit përcaktohen në brendinë e sylabusit dhe formula e vlerësimit të studentëve për çdo lëndë, është prezantuar në plan-programin e secilës lëndë. Në fillim të çdo semestri pedagogët u bëjnë të ditur studentëve modelin dhe formulën e zgjedhur për vlerësimin e njohurive të lëndës përgjatë semestrit dhe në fund të tij.

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	20%
Testimet gjatë vitit	30%
Provimi përfundimtar	40%
Etj	20%
Në total	100%

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Departamenti i Shkencave të Edukimit ka në focus të veprimtarisë së tij organizimin e aktiviteteve kerkimore shkencore me të gjithë stafin akademik të institucionit si dhe me aktorë të tjerë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në funksion të realizimit të programit mësimor aktivizimi i studentëve të Masterit të “Psikologjisë së Këshillimit dhe të Pedagogjisë” në fushën e kërkimit shkencor është gjithmonë prezent dhe ka sjellë një përvojë të mirë në këtë institucion. Përfaqësues të njësisë na informuan se studentët janë aktivë në veprimtaritë shkencore të organizuara brenda dhe jashtë vendit.

Të dhënat nga RVB për aktivizimin e studentëve në aktivitete shkencore:

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	5
Për projekte shkencore në rang Departamenti	10
Për punime shkencore në rang Fakulteti	23
Për punime shkencore në bashkëpunim me të tjerë	25

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Procedurat e pranimit të studentëve në programin Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji, ashtu sikurse janë paraqitur edhe në RVB, janë bërë sipas përcaktimeve në zbatim të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe më vonë, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, këto procedura janë përshtatur sipas Ligjit aktual të Arsimit të Lartë. Studentët pajisen me një adresë elektronike, e cila e lehtëson marrjen e informacionit përmes sistemit BIS për regjistrim në ciklin e dytë të studimeve për të cilën janë të interesuar. Ky sistem ka rritur transparencën dhe kontrollin nga ana studentëve.

Personat e interesuar për regjistrim në programin e studimit “Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” priten nga Zyra e Pranimit e cila i orienton për procedurat që duhet të ndjekin për regjistrim si dhe ju ve në dispozicion informacionin për programin e studimit.

Sipas RVB në programin “Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” mund të regjistrohen shtetas shqiptarë ose të huaj kur plotësojnë kushtet:

- Mesataren e studimeve të ciklit të parë në masën 70%;
- Intervista nga Komiteti Shkencor i departamentit në masën 30%;
- Përshtatshmëria e programit të studimit pararendës me atë për të cilin aplikon sipas përcaktimit të bërë në rregulloret specifike të programeve të ciklit të dytë;
- Plotësimi i kushtit të mbrojtjes së një prej pesë gjuhëve të huaja në nivelin B1, sipas përcaktimit të Udhëzimit nr.52 datë 03.12.2015.

Studentët shqiptarë dhe të huaj pranohen në programin “Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji” nëse plotësojnë kushtet:

- Të vërtetojnë me një dokument zyrtar mbarimin e studimeve të ciklit të parë me diplomë “Bachelor” në Shqipëri ose jashtë shtetit (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga MASR);
- Plotësojnë kushtet e tjera të përcaktuara në rregulloren e brendshme të KUB-it;
- Pranojnë pagesën e tarifës të caktuar mujore ose vjetore.

Nga të dhënat e RVB si dhe të një dosje nga zyra e sekretarisë së KUBI-it e studentit të këtij programi studimi, rezulton dokumentacioni si më poshtë:

- Diplomë Bachelor e noteruar (të huaj) me vulë apostile e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noteruar për studentë të huaj ose ato shqiptarë me diplomë të huaj;
- Listë notash (me vulë apostile, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noteruar për studentët e huaj ose ato shqiptarë me diplomë të huaj);
- Diploma e shkollës së mesme së bashku me listën e notave të noterua (me vulë apostile, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noteruar për studentët e huaj ose ato shqiptarë me diplomë të huaj);
- Curriculum vitae (CV);
- 2 foto;
- Certifikata e njohjes së gjuhës së huaj për studentët e programeve “Master të Shkencave”;
- Fotkopje e mjetit të indentifikimit (e pasaportës për studentët e huaj);
- Mandati i pagesës;
- Lejë qëndrimi për studentët e huaj (dorëzohet deri në tre muaj nga data e regjistrimit).

Përveç Këshilltarit Akademik, studentët ndihmohen në drejtim të planifikimit dhe fuqizimit të karrierës së tyre përmes Këshilltarëve të karrierës, të cilët ofrohen përmes Zyrës së Planifikimit të Karrierës si dhe nga Zyra e Alumnit përmes ndarjes së përvojës së tyre të shkollimit dhe të punësimit.

Studentët janë të përfaqësuar në disa nivele dhe organizma brenda KUB, si në: Senatën Akademik; Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe në Komisione të tjera të përhershme.

Ashtu sikurse paraqitet edhe në RVB, deklarohet nga stafi akademik dhe konfirmohet nga vetë studentët, studentët mbahen vazhdimisht të informuar lidhur me të gjitha zhvillimet që ndodhin në KUB, përmes njoftimeve verbale, afishimeve në tabelat përkatëse dhe njoftimeve përmes sistemit BIS ose në faqen zyrtare në internet.

Sa i takon procesit të pranimit të studentëve në terma të programeve bachelor që ata kanë përfunduar përpara se të ndjekin studimet në programin Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji, KUB i pranon studentët duke bërë vlerësimet e mëposhtme:

a) Pa plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:

Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë		Kredite për t’u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji	0 Kredite
	Arsim Fillor dhe Parashkollor	0 Kredite

Nga institucione të tjera të arsimit të lartë		Kredite për t’u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	1. Psikologji shkollore	0 Kredite
	2. Psikologji	0 Kredite
	3. Pune sociale	0 Kredite
	4. Pedagogji/Arsim Fillor/Arsim parashkollor	0 Kredite
	5. Programe të ngjashme studimi	0 Kredite

b. Me plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:

Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë		Lëndët	Kreditë për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	Departamenti i Shk të Komunikimit Departamenti i Shk. Islame Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze	1. Parimet e Këshillimit dhe Pedagogjisë 2. Psikologji e Edukimit 3. Menaxhim i Klasës	5 ECTS 5 ECTS 5 ECTS
Totali		3 lëndë	15 ECTS

Sipas të dhënave të paraqitura në këto tabela, rezulton se iu jepet e drejta për t'u regjistruar në programin e studimit "Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji" edhe studentëve të cilët janë diplomuar në programe studimi të fushave të tjera, përveç Bachelor në Psikologji.

Pavarësisht faktit se KUB ka vlerësuar se studentët e diplomuar në fusha të tjera duhet të kenë detyrimin që të marrin disa lëndë të tjera si parakusht për të fituar të drejtën për t'u regjistruar në këtë program studimi, GVJ vlerëson se duhet cilësuar se Ligji Nr. 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë", në Nenin 7 të tij, "Kriteret e Anëtarësisë", në pikën 2/b përcakton qartë se "Anëtarët e Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme: b) të kenë diplomën e studimeve të larta "Bachelor" dhe "Master shkencor" ose "Master profesional" në psikologji ose ekuivalent me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin".

Bazuar mbi sa më sipër, programet e studimit Bachelor në "Punë Sociale" apo ato që cilësohen si "Programe të ngjashme studimi", penalizojnë licensimin e studentëve të diplomuar në programin e studimit "Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji", pasi nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara për anëtarësim në Urdhrin e Psikologut dhe fitimin e të drejtës për të ushtruar profesionin, sipas përcaktimeve të ligjit të sipërcituar.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Cilësia në hyrje të studentëve ndër vitet akademik 2013-2018 varion nga 2.45 deri 3.25 me një notë mesatare ndër 6 vitet 2.87 (në vitin 2013) në 8.51.

Ndërsa në dalje vihet re një tendencë në rritje të mesatares dalëse të studentëve në përfundim të programit të studimit, e cila varion nga 3.46 deri në 3.58 me një mesatare vjetore në 3.52.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare.

Referuar RVB, si dhe të dhënat në tabelën 43, më poshtë janë paraqitur në formë të përmbledhur të dhënat sa i takon mesatareve hyrëse (të studentëve të regjistruar në vitet akademike 2013-2018).

Programi i studimit Msc në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji	Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)	Nota mesatare	Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)	Nota mesatare
2013	8	2.64	0	0
2014	2	2.45	1	3.58

2015	8	3.25	1	3.52
2016	11	3.2	0	0
2017	15	2.77	6	3.55
2018	12	3.11	6	3.46
Në total	56	2.87	14	3.52

Ndërsa në tabelën 44 të RVB, tabelë në të cilën flitet për transferimet të dhënat për studentët janë si më poshtë:

Sipas Viteve	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar sipas viteve (b)						Totali i Studenteve të transferuar (b)	Totali (a)+(b)
			Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V	Viti VI		
2013-2014	8	2.67	0	0	0	0	0	0	0	8
2014-2015	2	2.45	0	0	0	0	0	0	0	2
2015-2016	8	3.25	0	0	0	0	0	0	0	8
2016-2017	11	3.02	0	0	0	0	0	0	0	11
2017-2018	19	2.87	0	0	0	0	0	0	0	19
2018-2019	12	3.11	0	0	0	0	0	0	0	12

Përsa më sipër, referuar të dhënave të dy tabelave të paraqitura në RVB, në kolonën e parë ku shkruhet numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin e parë për vitin akademik 2017-2018 rezultojnë 15 studentë në tabelën e parë dhe 19 studentë në tabelën e dytë. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin e parë 2017-2018 rezultojnë 19 nga të cilët 1 ishte çregjistruar. Numri total i studentëve që ndjekin aktualisht këtë program studimi është 30 studentë.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Mbështetur në të dhënat e vëna në dispozicion nga RVB rezultojnë se për vitin 2018 studentë të diplomuar në programin MSC në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji" pa vite përsëritje janë 6 (gjashtë) me notën mesatare 3.52

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Institucioni mbështet dhe i kurajon studentët që të marrin pjesë në programe të ndryshme shkëmbimi brenda dhe jashtë vendit. Studentet Xh. M. dhe M. Sh. studente të Masterit të Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji kanë marrë pjesë në programe shkëmbimi jashtë vendit. Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga RVB si dhe nga Zyra e Sekretarisë rezultojnë se në KUB-it nuk ka asnjë rast të transferimit të studimeve në programin Msc. në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Nga RVB numri i të diplomuar në MSC në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji" dhe të punësuarve është rreth 50%. Megjithatë, këto të dhëna janë marrë nga RVB dhe nuk ka dokumentacion i cili të dëshmojë se studentët e

diplomuar në këtë program studimi kanë përfituar të drejtën për t'u punësuar si psikologë të licensuar në zbatim të ligjit "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë".

Të dhëna për punësimin e studentëve

Studentët pas diplomimit janë punësuar kryesisht pranë institucioneve arsimore me të cilat KUB është partnere.

Numri total të diplomuarve 40 studentë

Periudha e të dhënave			
Programi i studimit	Numri i të diplomuarve	Numri i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
Msc në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji	40	18	10

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Mbështetur në të dhënat e RVB si dhe nga informacionet në takimet e organizuara me studentët RVJ është informuar se nga studentët e diplomuar, 18 prej tyre janë punësuar në përputhje me diplomën në institucione arsimore si dhe në KU"Bedër".

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Numri i të punësuarve jo në përputhje me diplomën është 10.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimi të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimi dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimi.</p>	<p>Studentet që ndjekin programin e studimit "Master i Shkencave në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji" duhet të zotërojnë diplomë universitare "Bachelor" dhe të kenë grumbulluar 180 kredite ECTS. Preferohen studentët që kanë mbaruar programin Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji ose të ngjashëm me të.</p> <p>Pranimi dhe regjistrimi i aplikantëve për këtë program studimi bëhet në përputhje me Ligjin 80/2015 dt 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", udhëzimeve normative të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Statutin dhe Rregulloren e KU Bedër" si dhe Rregullores së Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji".</p> <p>Pranimi i studentëve në "Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji", realizohet mbështetur në kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Programit Master Shkencor për pjesën e kushteve specifike të pranimi të studentëve.</p> <p>Studentët që kanë ndjekur këtë program studimi, sikurse u konstatua nga shqyrtimi i dokumentacionit në sekretarinë mësimore, janë pranuar konform ligjit dhe rregulloreve në fuqi.</p> <p>Institucioni vlerëson në mënyrë periodike ecurinë e studentëve, duke propozuar edhe përmirësimin e kriterëve</p>

	<p>të pranimit. Kjo detyrë realizohet kryesisht nga njësia bazë për programin.</p> <p>Duke respektuar rregulloren e ciklit të studentët japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master i Shkencave" niveli i gjuhës angleze është C1 sipas kuadrit evropian të gjuhëve.</p> <p>Konstatuam se institucioni rishikon politikën e pranimit të studentëve dhe në përputhje me nevojat harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Nga komunikimi me përgjegjësën e zyrës së Këshillimit u informuam se studentëve u vihet në dispozicion informacioni i plotë për mundësitë e punësimit pas diplomimit. Kjo zyrë duhet të kishte informuar studentët për daljen e Ligjit mbi Urdhërin e psikologut që për punësim është e domosdoshme dhënia e provimit për licensim.</p> <p>Studentët e interesuar për programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji të pyetur në lidhje me procesin e akreditimit të institucionit janë të mirë informuar nga Zyra e marrëdhënieve me Publikun për vlefshmërinë e programit brenda dhe jashtë vendit si dhe për procesin e akreditimit të institucionit.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës iu ofron studentëve një shërbim të vazhdueshëm lidhur me kërkesat e tregut për punësimin si dhe me mënyrat e aplikimit për punësim.</p> <p>Studentët e pyetur nga GVJ në takimin e organizuar në kuadrin e riakreditimit të programit lidhur me punësimin e tyre, ata pohuan se do të punësoheshin si psikologë pranë institucioneve arsimore.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>KUB-it ka një strukturë të mirëorganizuar që mundëson menaxhimin e të diplomuarve në programet e studimit. Në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Studentët është ngritur Zyra e të diplomuarve. Në takimin e organizuar me përfaqësues të kësaj zyre si dhe të sekretarisë mësimore u informuam për kontaktet e vazhdueshme dhe për mbajtjen e statistikave vjetore për të diplomuarit në programet e studimit.</p> <p>Informacioni i plotë për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë u ofrua nga zyra e sekretarisë mësimore. Çdo student ka dosjen individuale pranë kësaj zyre dhe kjo mundëson mbajtjen e rregullt të statistikave për regjistrin e studentëve të programit Master i Shkencave në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji".</p> <p>U njohëm me të dhënat për ecurinë akademike që institucioni e realizon nga sekretaria e departamentit. Rezultatet vihen në dispozicion të sekretarisë mësimore dhe prej aty Zyra për Planifikimin e Karrierës ndjek në vazhdimësi ecurinë akademike nga praktika profesionale deri në diplomimin e studentëve.</p>

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;

Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.

Institucioni ka një database me bazë të dhënash për studentët që kanë përfunduar studimet në ciklin e dytë dhe janë të dhënat për ata që janë të punësuar.

Pas përfundimit të ciklit të dytë të studimeve referuar RVB konstatoam se ka edhe studentë që paraqesin interes për të vazhduar studimet edhe në ciklet e tjera të studimeve. Këto të dhëna janë në Zyrën e të diplomuarve.

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;

Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;

Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.

Çdo njësi në institucion informon studentët nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë ose online për programin e studimit, kurrikulën, lëndëafatin e përfundimit të studimeve, statusin e akreditimit të institucionit dhe programit të studimit.

Informacioni për rezultatin e vlerësimit të programit të studimit, institucioni e bën transparent në faqen e internetit për tu njohur nga stafi akademik si dhe nga studentët e programit Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji.

Në përfundim të modulit si dhe të semestrit, rezultatet e vlerësimeve diskutohen hapur me studentët nga përgjigjësi i modulit.

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Ne institucionin "Bedër" në qënder të vëmendjes është mbështetja e studenteve për të arritur rezultate sa më të mira gjatë viteve të studimit.

Studentët e këtij cikli studimi mbështeten gjatë gjithë procesit të formimit akademik nga Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës.

KU "Bedër" ndihmon në sitemimin e studentëve dhe njëherësh në orientimin e praktikës, duke adresuar, sipas specifikave, realizmin e një produkti teorik - aplikativ nga secili student.

Konkluzionet e vlerësimit:

Në KU "Bedër" pranimet e studentëve realizohen në zbatim të legjislacionit të Arsimit të Lartë të RSH mbështetur në Statutin dhe Rregulloren e institucionit si dhe rregulloren e programit të studimit.

Studentët kanë marrë informacionet e nevojshme për mundësitë që ofrojnë programet e studimit për punësim si dhe të dhëna për performancën e institucionit në vite në drejtim të punësimit.

Konstatuam se studentët e këtij programi studimi nuk janë të informuar se me daljen e Ligjit të Urdhërit të Psikologut, programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji nuk do t'ua sigurojë licensimin si psikolog dhe punësimin në këtë profesion.

Institucioni ta rishikojë riorganizimin e programit, për të realizuar licensimin e studentëve në profesionin në të cilin do të duan të punësohen, si psikologë.

Ne institucionin "Bedër" ka dokumentacion statistikor për numurin e studentëve të regjistruar në programin Master i Shkencave .

Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, funksionon si strukture e vecante dhe ofron shërbime këshillimore edhe për studentët e programit Master i shkencave në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji".

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësisia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Politikat e kërkimit shkencor zenë një vend të rëndësishëm në KU "Bedër" dhe kjo realizohet nëpërmjet Zyrës së Kërkimit Shkencor. Në politikat e kërkimit shkencor institucioni inkurajon dhe i mbështet financiarisht stafin akademik për të bërë kërkime dhe projekte shkencore përmes një fondi të deklaruar prej 700 Eurosh. Po kështu sipas informacionit nga stafi akademik institucioni ofron edhe mbështetje financiare për pjesëmarrjen e secilit anëtar të stafit në konferenca dhe në veprimtari shkencore.

Departamenti i Shkencave të Edukimit është njësisia me dinamike e institucionit për organizimin e studimeve në shkencat e edukimit dhe realizon çdo vit botimin e Revistës Shkencore me ISSN dhe me bord editorial Bedër Journal of Educational Sciences (BJES)

Në vitin akademik 2013-2014 janë botuar Vëllimi 4, 5, dhe 6
Në vitin akademik 2014-2015 janë botuar Vëllimi 7, 8, dhe 9
Në vitin akademik 2015-2016 janë botuar Vëllimi 10,11 dhe 12
Në vitin akademik 2016-2017 janë botuar Vëllimi 13 numër 1, 2, 3
Në vitin akademik 2017-2018 janë botuar Vëllimi 14, 15, 16

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (Shiko Anekse, tabela 9 dhe Tabela 10)

Departamenti i Shkencave të Edukimit në bashkëpunim me Zyrën e Kërkimit Shkencor kanë organizuar ndër vite një sërë aktivitetesh shkencore në fushën e psiko-pedagogjisë. Janë organizuar 6 edicionesh konferencash kombëtare ku janë mbajtur 374 kumtesa me pjesëmarrjen e 435 pjesëmarrës ku kanë marë pjesë 10 shtete të ndryshme të botës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Personeli akademik i KU "Beder" kontribuon nëpërmjet publikimeve të artikujve dhe materialeve shkencore në fushën e psikologjisë dhe të pedagogjisë dhe janë pjesëmarrës në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit. Institucioni "Beder" publikon Revistën Shkencore me ISSN dhe me bord editorial Beder Journal of Educational Sciences (BJES) që përmban shkrime shkencore të pedagogëve dhe specialistëve sipas fushës. Një pjesë e mirë e stafit akademik ka botuar studime dhe artikuj shkencore në revista të njohura në fushën e edukimit.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në	Referuar RVB si dhe të dhënave nga Zyra e burimeve njerëzore personeli mësimdhënës i programit Master i Shkencave në Psikologji Këshimmi dhe Pedagogji zotërojnë certifikatë të njohjes së avancuar të gjuhës angleze.

mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Mbështetur në të dhënat personale të stafit akademik rezulton se mësimdhënësit në këtë program studimi kanë një përvojë të gjatë pune në këtë institucion si mësimdhënës të gjuhës angleze.
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	Konstatuam se në KU "Beder" organizohen trajnime dhe hartohen programe kualifikimi me trupën akademike për përditësimin e metodave dhe teknologjive të reja në mësimdhënie, përfshirjen në programet studimore të disiplinave të reja, të informacionit të ri. Në këto veprimtari kanë referuar pedagogë me kohë të plotë por edhe specialistë të huaj dhe në këtë veprimtari marin pjesë i gjithë personeli akademik, administrativ si dhe studentët. Institucioni "Beder" ka mbështetur me alokim fondesh ndër vite një numur pedagogësh për kualifikime jashtë vendit dhe pjesëmarje në veprimtari shkencore në vende të ndryshme.
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Në zyrën e e Burimeve njerzore janë të depozituara të gjitha të dhënat të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimesh të cilat përputhje me kriteret e pozicionit të punës.</p> <p>Institucioni disponon një database të plotë të dhënash për veprimtarinë të planifikuar botuese të stafit akademik, ku evidentohen botime me karakter shkencor, studime, monografi, pjesëmarje në veprimtari me karakter shkencor brënda dhe jashtë vëndit.</p> <p>Veprimtaria shkencore e stafit akademik pasqyrohet në raportin vjetor të veprimtarisë akademike dhe depozitohet në dosjen personale të pedagogëve.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>Institucioni "Beder" ka krijuar kushte optimale për zhvillimin e veprimtarive studimore shkencore si në rrafshin institucional ashtu dhe atë individual.</p> <p>Personeli akademik ka marrë pjesë në vite në veprimtari shkencore të organizuara nga institucioni, por edhe nga institucione homologe brënda dhe jashtë vendit.</p> <p>KU "Bedër" publikon Revistën Shkencore me ISSN dhe me bord editorial Beder Journal of Educational Sciences (BJES) që përmban shkrime shkencore të pedagogëve dhe specialistëve sipas fushës .</p> <p>Personeli akademik është përfshirë në një proces kualifikimi shkencor individual dhe institucional të vazhdueshëm.</p> <p>KU "Beder" disponon dokumentacion të rregullt për veprimtarinë kërkimore shkencore, botuese për pedagoge dhe ky shërben edhe si një tregues për vlerësimin e profesionalitetit të tyre shkencor.</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Kolegji Universitar Bedër, prej viti 2012 ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 56 institucione, ndër të cilat pjesa më e madhe prej tyre janë institucione të arsimit të lartë, bashki, institucione publike dhe private.

Marrëveshjet e bashkëpunimit synojnë të realizojnë disa qëllime:

- Plotësimin e nevojave për praktikë profesionale të studentëve për programe dhe nivele të ndryshme studimit;
- Realizimin e konferencave të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare me interes të ndërsjelltë;
- Realizimin e trajnimeve të ndërsjellta midis stafëve të dy institucioneve, etj

Ashtu sikurse përcaktohet në RVB, në vitet 2012-2018, KUB ka realizuar rreth 26 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me institucione si brenda edhe jashtë vendit. Në takimin me drejtuesen e Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare u cilësua se numri më i madh i marrëveshjeve të bashkëpunimit është realizuar në periudhën 2012-2015. Ndërkohë që vitet e fundit ka ndryshuar trendi i marrëveshjeve të realizuara, përmes realizimit të marrëveshjeve me programin Erasmus + dhe mundësinë për të firmosur marrëveshje shkëmbimi me dy universitet kineze. Ndër vite, anëtarë të stafit të KUB kanë përfituar nga mobiliteti duke patur mundësinë të angazhohen në mësimdhënie në periudha të caktuara në vende të ndryshme të botës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Shiko Anekse, tabela 11 dhe Tabela 12)

Ashtu si është paraqitur në RVB dhe sikurse na u komunikua nga përfaqësuesja e Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare, në kuadër të pjesëmarrjes së stafit akademik dhe të studentëve të programit të studimit Msc në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji në aktivitete të bashkëpunimit ndërkombëtare, treguesit janë paraqitur në tabelën 40 të RVB, sipas të cilit:

- Studentët që kanë përfituar nga mobiliteti janë 6;
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë KUB dhe prezantime janë 7.

Ashtu sikurse u qartësua edhe në pikën 10 të RVJ, Kub mbështet vazhdimisht stafin akademik për pjesëmarrje në aktivitete të natyrës kërkimore shkencore edhe në mbështetje të bashkëpunimit ndërkombëtar.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

Ashtu sikurse është paraqitur edhe në RVB, KUB ka aktive 43 marrëveshje me universitete ndërkombëtare, 8 marrëveshje me institucione/organizata profesionale publike dhe private si dhe 2 marrëveshje me komunitetin e biznesit. Këto marrëveshje firmosen kryesisht për një periudhë 4-5 vjeçare dhe, në kushte të mungesës së kërkesës për rishikim të kushteve, kontrata cilësohet si e rinovuar edhe për një periudhë tjetër po aq vjeçare.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	Programi që është ofruar për riakreditim është Master i Shkencave, program i ciklit të dytë . Për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji", Kolegji Universitar "Beder" ka bashkëpunuar me institucionet e Arsimit të lartë në fushën për kryerjen e praktikave profesionale, në sferen e publikimeve në fushën e pedagogjisë dhe të psikologjisë, si dhe me institucione të tjera jashtë vendit.
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhëniet të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion konstatuam një bashkëpunim të ngushtë midis organizmave mësimore si dekanat, departamente dhe studentë por edhe ndërmjet vetë personelit, një frymë bashkëpunimi në interes të forcimit të komponentit të cilësisë në përgatitjen e studenteve.</p> <p>Brenda institucionit ka një atmosferë pozitive pune dhe frymë kolegjaliteti që është rrjedhojë e një ndarje të qartë të përgjegjësisë dhe roleve të gjithsecilit anëtar të trupës akademike në sistemin e mësimdhënies dhe kontrollit të cilësisë së dijeve</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhëniet bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhëniet bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhëniet bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkëpunim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në realizimin e objektivave të programit të studimit Master i Shkencave institucioni ka përcaktuar qartë bashkëpunimin me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit mbi bazën e marrëveshjes dypalëshe bashkëpunimi .</p> <p>Institucioni zhvillon marrëdhëniet partneriteti me organizmat ,organizatat, komunitetin e biznesit si dhe institucione vendas dhe të huaj për kryerjen e praktikave profesionale në varësi të programeve që ka ofruar.</p> <p>Me këto institucione, GVJ Ju komunikua se KU “Beder” ka organizuar veprimtari të ndryshme si ëorkshop, kurse trajnimi, me qëllim të forcimit të këtyre lidhjeve në dobi të përgatitjes profesionale të studentëve.</p> <p>Institucioni “Beder” harton një raport analitik mbi këto marrëdhëniet bashkëpunimi, parë ato në funksion të realizimit të objektivave dhe misionit të tij</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Institucioni “Beder” për realizimin e programeve të studimit ka vendosur dhe zhvillon marrëdhëniet bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, dhe ka organizuar në vite një sërë konferencash, seminaresh, simpoziume shkencore, shkëmben informacion dhe përvoja me to bën trajnime të përbashkëta të personelit akademik, leksione të hapura me personalitete të shkencës vendas e të huaj etj Studentet e KU”Beder” i kryejnë praktikatat mesimore në institucione të ndryshme në fushën e Arsimit, si dhe në organizatat e biznesit me të cilat janë nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit.</p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

KUB ka plotësuar kryesisht rekomandimet e dhëna nga KA në vendimin për akreditimin e parë.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

Pikat e forta

1. Mbështetje financiare e stafit akademik për kërkimin shkencor në mënyrë të përvitshme
2. Bibliotekë voluminoze dhe shërbim orientues për punën me literaturën
3. Mësimdhënia në gjuhën angleze lehtëson shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore
4. Zotërimi i një numri shumë të madh marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione arsimore, gjë e cila lehtëson kryerjen e praktikave të studentëve në institucione të kësaj natyre



Pikat e dobëta

1. Profili mis i programit midis Psikologjisë dhe Pedagogjisë, e pengon licensimin e studentëve të diplomuar si "psikolog"
Rekomandohet qartësimi i profilit të programit, ose Psikologji, ose Pedagogji
2. Numri i personelit akademik të profilit të Psikologjisë
Rekomandohet shtimi i këtij numri në këtë profil
3. Mësimdhënia në gjuhën angleze e vështirëson të nxënit, panvarësisht përpjekjese të KU Beder për të ndihmuar studentët në arritjen e një niveli të kënaqshëm të gjuhës angleze në fillim të studimeve (Aktualisht Institucioni ka bërë kërkesë në MASR për ofrimin e këtij programi në gjuhën Shqipe)

Mundësitë

1. Partneriteti në shumë rrjete institucionesh universitare apo projekte shkëmbimi ose kërkimore lehtëson rritjen e kapacitetit të stafit duke ofruar mundësinë e rekrutimit të një numri më të lartë të anëtarëve të stafit akademik me profil "Psikologji";
2. Me hyrjen në fuqi të VKM nr. 41 datë 24/01/2018, KU Beder mund të riorganizojë programin e studimit duke e profilizuar në njërin nga fushat: Psikologji ose Pedagogji;
3. Biblioteka tejet voluminoze mund ta kthejë KU Beder në një institucion mbështetës për rritjen akademike dhe punën kërkimore të stafit akademik dhe studentëve të institucioneve të tjera të Arsimit të Lartë.

Pengesat

1. Ndryshimet e vazhdueshme të kritereve të pranimit në Universitet për profilin e Psikologjisë (mesararja hyrëse);
2. Numri në rritje i programeve Master që oftohen nga Universitete të tjera.

SWOT Analysis

Strengths:

1. Continuous financial support of academic staff on terms of scientific research;
2. Voluminous library and orientation service towards to work with the literature;
3. Teaching in English enhances the usage of contemporary literature;
4. Having a long list of MoU with other educational institutions facilitates the professional practice of the students in institutions of such nature;

Weaknesses:

1. The mixed profile of the program, between Psychology and Pedagogy, enables the licencing process as a "psychologist" of students who have a diploma in this mixed program. The clarification of the program is highly recommended;
2. The small number of academic staff of Psychology profile. Recruitment of new academic staff is highly recommended;
3. Teaching in English complicates the learning process, despite the efforts of University College Beder to help students reach a good starting level of English in the beginning of their Studies. Actually, the institution has applied to offer this program in Albanian.

Opportunities:

1. The partnership with a large network of institutions of higher education and the participation in regional research or exchange programs, enhances the development of capacity building of the academic staff, creating an opportunity to recruit a higher number of academic staff specialized in Psychology;
2. After Order of Counsel of Ministers, No 41, date 41/01/2018, UC Beder can reorganise this study program by profiling it in one of the fields; Psychology or Pedagogy;
3. The voluminous library can turn CU Beder in a supporting institution for the research projects of other academic staff or students of other Higher Education Institutions.

Threats:

1. The continuous change of acceptance criteria in University, especially the ones related to psychology (acceptance mean grade);
2. The growing number of Master in Psychology programmes offered by other higher education institutions.